NO. **5813**, VITI XVI. **GAZETË E PËRDITSHME.** WWW.ZERI.INFO - WWW.ONLINE.ZERI.INFO

E MARTË, 5 DHJETOR 2017. **ÇMIMI 40 CENTË.** | like > facebook.com/gazetazeri follow > twitter.com/gazeta_zeri

ZËRI

Kontestohet kufiri! 04



Ndërkombëtarët: Miratojeni Demarkacionin, është i saktë!

Zyrtarë të Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, të Ambasadës së Francës e Norvegjisë kanë deklaruar për gazetën "Zëri" se deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta miratojnë versionin aktual të Demarkacionit, pasi marrëveshja e vitit 2015 e ruan kredibilitetin ndërkombëtar të Kosovës



02

Ditari

Haradinaj: Përfaqësimi i komuniteteve, i garantuar

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur dje në takim përfaqësuesit e Këshillit Konsultativ për Komunitete, të udhëhequr nga kryesuesi i këtij Këshilli, Gazmen Salijeviq. Siç bëhet e ditur në komunikatën për medie të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, në takim u bisedua... > Faqe 02

Sport



Bëhet në Drenas

Qeveria e Kosovës i ka mëshuar vulë lokacionit të ndërtimit të Stadiumit Nacional. Të hënën është hequr çdo dilemë, pasi u vendos përfundimisht që njëri prej projekteve më të rëndësishëm pasluftës të ndërtohet në Drenas, edhe pse fillimisht ishte... > Faqe 12

KRONIKA - FAQE 06

TAHIRI: PRIORITET, LUFTIMI I KORRUPSIONIT



PZAP-i hedh poshtë ankesat e LDK-së e të PDK-së

> Faqe 03





4 195871 701104

02

Haradinaj: Përfaqësimi i komuniteteve, i garantuar

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur dje në takim përfaqësuesit e Këshillit Konsultativ për Komunitete, të udhëhequr nga kryesuesi i këtij Këshilli, Gazmen Salijeviq.

Siç bëhet e ditur në komunikatën për medie të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, në takim u bisedua për punën e Këshillit si kategori kushtetuese dhe koordinimin e tij me Zyrën për Komunitete. Kryesuesi i Këshillit, Gazmen Salijeviq dhe anëtarët e informuan Haradinajn me punën e tyre dhe theksuan nevojën e zbatimit të rekomandimeve nga ministritë përkatëse. Haradinaj tha se komunitetet joshumicë janë pjesë integrale e Republikës së Kosovës dhe përfaqësimi i tyre është i garantuar. Ai shtoi se do ta intensifikojë bashkëpunimin në implementimin e rekomandimeve të Këshillit.



Kryeministri njoftohet për përmbytjet në Shqipëri

Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të hënën në takim ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ministrin e Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Ramën dhe drejtorin e Policisë, Shpend Maxhuni.

Kryeministri Haradinaj u njoftua nga ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, me gjendjen e krijuar pas përmbytjeve nga moti i lig, që ka përfshirë Republikën e Shqipërisë dhe përpjekjet për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të prekur nga vërshimet në zona të ndryshme. Ministrat Berisha dhe Sefaj, si dhe drejtuesit e FSK-së dhe të Policisë së Kosovës e njoftuan kryeministrin Haradinaj me koordinimin e institucioneve të Kosovës me ato të Shqipërisë për të ndihmuar në këtë situatë të vështirë.

"Kryeministri Haradinaj tha se Kosova do të vazhdojë të jetë përkrah Shqipërisë në këtë situatë të rëndë dhe theksoi se Qeveria e vendit ka ofruar ndihmën e gjithanshme pas përmbytjeve në Shqipëri përmes njësive të FSK-së dhe agjencive të emergjencave. Ai tha se është me rëndësi që të bëhet koordinimi i institucioneve të vendit me ato të Republikës së Shqipërisë për veprimet e nevojshme me qëllim që t'i dilet në ndihmë shtetit shqiptar dhe banorëve të zonave të përmbytura", thuhet në komunikatën për medie të Qeverisë së Kosovës.



Ndërkombëtarët: Miratojeni Demarkacionin, është i saktë!

Arbesa Ibrahimi / Prishtinë

Pavarësisht raportimit të Komisionit të Ri për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi, i cili konstatoi se Kosova humb territor nga versioni aktual i Demarkacionit, përfaqësuesit e huaj diplomatikë në Kosovë kanë thënë se kjo marrëveshje është e saktë dhe si e tillë duhet ratifikuar. Madje sipas tyre, komisionet e mëparshme (duke përfshirë edhe atë ndërkombëtar) kanë bërë një ekzaminim të përgjithshëm rreth kësaj marrëveshjeje që tregon për saktësinë e kësaj marrëveshjeje.

Ambasada e Francës në Kosovë ka thënë për "Zërin" se të dyja palët, edhe ajo e Kosovës, edhe ajo e Malit të Zi, ishin pajtuar që ta nënshkruanin Marrëveshjen e Demarkacionit para më shumë se dy vjetësh. "Marrëveshja për Demarkacionin e Kufirit, e arritur në vitin 2015, ishte nënshkruar nga Qeveria e Malit të Zi dhe nga Qeveria e Kosovës. Të dyja palët u pajtuan kështu së bashku për të definuar vijën kufitare", thuhet në përgjigjen e kësaj Ambasade. Andaj, sipas zyrtarëve të saj, Marrëveshja e Demarkacionit mes dy shteteve duhet të miratohet. "Kjo marrëveshje duhet të ratifikohet. Ajo ka të bëjë me kredibilitetin ndërkombëtar të Kosovës. Ajo është po ashtu një kusht i domosdoshëm që Kosova të ecë përpara drejt liberalizimit të vizave", potencohet më tej.

Ndërkaq, Ambasada e Norvegjisë në Kosovë ka deklaruar se marrëveshja në fjalë, e arritur në vitin 2015, është krejtësisht e saktë. "Norvegjia beson se komisionet e mëparshme si në Kosovë, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, kanë bërë një ekzaminim gjithëpërfshirës, tërësor dhe objektiv të demarkacionit të kufirit midis Kosovës dhe Malit të Zi dhe beson se demarkacioni i përfunduar në marrëveshjen aktuale është e saktë", thuhet në përgjigjen e Ambasadës Norvegjeze dhënë "Zërit". Me këtë rast, duke folur rreth vendimit të Qeverisë që ta dërgojë në Kuvend Marrëveshjen e Demarkacionit, Ambasada ka thënë se Norvegjia e përshëndet vendimin në fjalë. "Norvegjia përshëndet vendimin për ta dërguar Marrëveshjen e Demarkacionit në Kuvend. Tani do të jetë në Kuvend që të marrë vendimin e saj. Me miratimin e marrëveshjes Kuvendi do ta lehtësojë integrimin e mëtejshëm të Kosovës në bashkëpunimin evropian", theksohet në përgjigje.

Ndërkaq, gjatë ditës së djeshme Komisioni i Ri Shtetëror, në krye me Shpejtim Bulliqin, duke prezantuar raportin përfundimtar para Qeverisë konstatoi se ish-Komisioni (i drejtuar nga Murat Meha) ka zhvendosur vijën kufitare mes Kosovës e Malit të Zi.

Fakte

BE: ZGJIDHJE SA MË TË SHPEJTË PËR DEMARKACIONIN

Edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE) ka kërkuar që Kosova ta gjejë një zgjidhje sa më shpejt sa i përket Marrëveshjes së Demarkacionit. "Është thelbësore që Kosova ta gjejë zgjidhjen më të mirë për bllokimin aktual të Demarkacionit përmes një debati të përfaqësuesve të zgjedhur dhe një vote, e cila jepet mbi bazën e pritjeve legjitime të popullit të Kosovës dhe të ardhmes së tyre evropiane", ceket në përgjigjen e Zyrës së BE-së dhënë "Zërit". Duke folur rreth vendimit të ekzekutivit që ta dërgojë këtë Marrëveshje në Parlament, BE-ja ka bërë të ditur se e ka mirëpritur një gjë të tillë. "BE-ja mirëpret që Qeveria vendosi sot sa i takon Kuvendit ta marrë vendimin përfundimtar lidhur me Demarkacionin e Kufirit", nënvizohet më tutje në përgjigjen e Zyrës së BE-së.



FOTO: LDRITON BUBLAKU

PZAP-i hedh poshtë ankesat e LDK-së e të PDK-së

Doruntina Thaqi / Prishtinë

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP-i) të hënën ka publikuar vendimet për ankesat që janë paraqitur nga partitë politike kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve komunale.

PZAP-i ka marrë vendim që t'i hedhë poshtë të gjitha ankesat nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila kishte dërguar ankesa për komunën e Prishtinës, të Dragashit dhe të Kamenicës. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe me ankesat e dërguara nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që dërgoi ankesa për komunën e Prizrenit, të Rahovecit e të Klinës.

Pas këtij vendimi zyrtarë nga LDK-ja kanë treguar për "Zërin" se do të dërgojnë ankesë në Gjykatën Supreme për të parë nëse ky vendim i PZAP-it është i vlefshëm apo jo. Të njëjtën gjë pritet ta bëjë edhe PDK-ja.

Ndërkohë, partitë politike kanë të drejtë ankese brenda 24 orëve në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit do të vendosë brenda 72 orëve. Mulë Desku, nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i), ka treguar për gazetën "Zëri" se PZAP-i ka marrë vendim që ankesat e dërguara nga Lidhja Demokratike e Kosovës për komunën e Prishtinës, të Dragashit dhe të Kamenicës, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja për zgjedhjet lokale ka vendosur që këto ankesa t'i hedhë poshtë, duke i cilësuar si të palejueshme, të pabazuara dhe të dërguara pas afatit të caktuar. "PZAP-i ka shqyrtuar dhe ka vendosur të gjitha apelet e paraqitura kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve komunale të 22 tetorit 2017 për rundin e dytë për kryetarë të komunave, të mbajtura më 19.11.2017. PZAP-i lidhur me apelet e paraqitura nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka vendosur si në vijim: Apeli për komunën e Prishtinës, një pjesë e apelit është hedhur si e palejueshme dhe një pjesë e apelit është refuzuar si i pabazuar, apeli për komunën e Dragashit është refuzuar si i pabazuar, apeli për komunën e Kamenicës është hedhur si i pasafatshëm", ka njoftuar Desku.

Ndërsa për ankesat e PDK-së për komunën e Prizrenit, të Rahovecit e të Klinës ka treguar që po ashtu janë hedhur poshtë, duke i cilësuar si të pabazuara dhe të palejuara. "PZAP-i lidhur me apelet e paraqitura nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka vendosur si në vijim: Apeli për komunën e Prizrenit është hedhur si i palejuar, apeli për komunën e Rahovecit, një pjesë e apelit është hedhur si e palejueshme dhe një pjesë e apelit është refuzuar si i pabazuar, apeli për komunën e Klinës është hedhur si i palejuar", ka sqaruar Desku.

Po ashtu PZAP-i ankesën e kandidatit të pavarur për komunën e Shtimes e ka hedhur poshtë. "Apeli i paraqitur nga kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Shtimes është hedhur si i palejuar", përfundoi Deksu.

Ndërkohë Haki Rugova, nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas vendimit të PZAP-it për t'i hedhur poshtë ankesat e këtij subjekti politik për Komunën e Prishtinës, të Dragashit e të Kamenicës, i tha gazetës "Zëri" se këtë vendim do ta dërgojnë në Gjykatën Speciale për ta parë nëse është i vlefshëm apo jo. "Tashmë është instanca tjetër, Gjykata Supreme dhe do të shohim, por ka afat deri nesër të dorëzohet një ankesë e tillë. Kjo ankesë dorëzohet sepse duhet të bëhet vlerësimi se a vlen apo nuk vlen", ka theksuar Rugova.

Kurse nga PDK-ja kanë deklaruar për gazetën "Zëri" se do ta shqyrtojnë së pari vendimin e PZAP-it dhe pastaj do të vendosin nëse do ta dërgojnë në Gjykatë Supreme apo jo.

Fakte:
PZAP-i ka marrë vendim që t'i hedhë poshtë të gjitha ankesat nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila kishte dërguar ankesa për komunën e Prishtinës, të Dragashit dhe të Kamenicës. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe me ankesat e dërguara nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që dërgoi ankesa për komunën e Prizrenit, të Rahovecit e të Klinës.

Për më shumë kontakto në: **redaksia@zeri.info**

ZËRI

Boton: NPIB "Zëri" · **Drejtor:** SHPEND DOBRANJA · **Kryeredaktor:** LAVDIM HAMIDI · **Zv. kryeredaktor:** ENIS VELIU · **Redaktorët:** Bardh Frangu (Kulturë, Fejtonistikë) · VALON KONUSHEVCI (Sport) · LULZIM XHEMA (ZIP) · GENT SELANI (Qendra Grafike) · LAURA HASANI (Fotografia) · **Drejtor financiar:** ISMAJL MUSLIU · **Drejtor i marketingut:** HEKURAN HOXHA · **Marketingu:** (038) 249 751 · **E–mail:** marketingu@zeri.info · **Xhirollogaria:** NLB Prishtina Nr. 1701001010829163 · **Adresa e redaksisë:** Pallati i shtypit p. n . / Aneksi, Prishtinë · Tel/Fax. (038) 249 071, Tel: (038) 222 451, mob: (044) 951 515 · E–mail: redaksia@zeri.info dhe zeri_d@hotmail.com · Shtypet në shtypshkronjën: **"Lindi Printing Center"** · Doreshkrimet nuk kthehen



Ditari

Kontestohet kufiri!



Raporti i final i Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi, i cili dje është prezantuar në Qeveri dhe është proceduar në Kuvend, është kritikuar ashpër nga partneri i madh i koalicionit qeverisës (PDK-ja), si dhe nga partia e ish-kryeministrit Isa Mustafa, sipas të cilëve, ky Komision nuk e ka sjellë asnjë fakt të ri për kufirin. Megjithatë raporti është përkrahur nga kryeministri Haradinaj, pasi që, sipas këtij të fundit, vërteton pretendimet e deritashme se Kosova me versionin e tanishëm të marrëveshjes humb territor

Arbesa Ibrahimi / Prishtinë

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që Marrëveshjen aktuale të Demarkacionit (të nënshkruar para më shumë se dy vjetësh) ta dërgojë në Kuvend. Bashkë me të Qeveria ka vendosur që në Parlament ta nisë edhe raportin përfundimtar të Komisionit të Ri Shtetëror për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi (të drejtuar nga Shpejtim Bulliqi). Kjo pasi gjatë ditës së djeshme ky komision prezantoi para Qeverisë raportin final për vlerësimin e punës së Komisionit paraprak, me ç'rast konstatoi se Kosova humb territor nga versioni i tanishëm.

Sipas anëtarëve të Komisionit të Ri, ish-Komisioni i drejtuar nga Murat Meha e ka zhvendosur kufirin mes Kosovës e Malit të Zi. Mirëpo, pavarësisht këtyre të gjeturave dhe pavarësisht se partia e kryeministrit Haradinaj (AAK) po vazhdon të insistojë që versioni aktual i shkakton humbje territorit të shtetit të Kosovës, partneri tjetër i koalicionit qeverisës, PDK-ja, po vazhdon të ngulë këmbë në të kundërtën. Sipas përfaqësuesve të këtij subjekti, Komisioni aktual nuk ka sjellë kurrfarë fakti të ri, përkundrazi, ka komplikuar më shumë situatën. Ata madje kanë bërë të ditur se do ta votojnë këtë version në momentin që do të shkojë në Kuvend. Kurse përfaqësuesit e lëvizjes "Vetëvendosje", ndonëse përshëndesin konkludimet e Komisionit të Ri, thonë se nuk pajtohen me vendimin e Qeverisë që raportin ta dërgojë në Kuvend bashkë me marrëveshjen aktuale.

Bulliqi: Ish-Komisioni ka përcaktuar vijë të re kufitare

Kryetari i Komisionit për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi, Shpejtim Bulliqi, duke prezantuar raportin përfundimtar dje para Qeverisë, ka thënë se ish-Komisioni, i drejtuar nga Murat Meha, ka përcaktuar vijë të re kufitare mes Kosovës e Malit të Zi. "Ish-Komisioni ynë ka tejkaluar kompetencat e veta, duke i lejuar vetes t'i futet përcaktimit të vijës së re mes Kosovës dhe Malit të Zi pa një marrëveshje ndërkombëtare paraprake. Kjo për faktin se në marrëveshjen e nënshkruar është thënë se çështja e demarkacionit është lënë të kryhet brenda dy vjetëve pasi të hyjë në fuqi kjo marrëveshje. Ish-Komisioni ynë ka qenë i thirrur ta shënjojë vijën e dikurshme kufitare dhe në asnjë mënyrë të shënjojë vijë të re kufitare me Malin e Zi", ka deklaruar Bulliqi.

Me këtë rast Bulliqi ka thënë se Komisioni i Ri ka konstatuar se vija kufitare e përcaktuar nga ish-Komisioni nuk përputhet me vijën administrative. "Në punën e ish-Komisionit Komisioni konstaton në mënyrë unanime se vija kufitare në Marrëveshjen për Kufirin mes Kosovës dhe Malit, të 26 gushtit 2015, nuk është në përputhje me vijën administrative kufitare të ish-krahinës socialiste autonome të Kosovës", ka shtuar ai.

Hoxhaj: Komisioni vetëm e ka komplikuar situatën

Pas këtij raportimi ka reaguar menjëherë zëvendëskryeministri (nga PDK-ja) Enver Hoxhaj, i cili gjatë mbledhjes së Qeverisë tha se ky komision nuk ka sjellë asnjë fakt të ri. "Meqë jemi në një takim shumë të rëndësishëm dhe disa herë kishte sqarime të caktuara, më lejoni t'ju falënderoj për punën që keni bërë si komision. Në takimin e parë që kam pasur kryeministër me ju ka qenë që të gjendet e vërteta dhe vetëm e vërteta. Unë dëgjova vlerësime të përgjithshme, por jo ndonjë provë materiale, jo ndonjë fakt konkret. Nuk ishit konkretë, nuk pashë ndonjë qartësi të re", ka deklaruar ai. Hoxhaj më tej tha se Komisioni aktual në vend se ta zgjidhë e ka komplikuar më shumë situatën. "Sot e kam përshtypjen që e keni komplikuar edhe më shumë situatën", theksoi ai.

Kjo bëri që të kundërpërgjigjet kryetari Bulliqi, i cili tha se puna e Komisionit nuk është ta akuzojë askënd, por ta publikojë të vërtetën. "Esenca dhe puna jonë nuk është që ta akuzojmë askënd, ne nuk kemi ardhur ta qesim para gjyqtarit askënd, ne kemi punuar për ta nxjerrë një të vërtetë. Jemi shumë të brengosur për gjendjen në të cilën jemi", nënvizoi ai.

Fakte

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që Marrëveshjen aktuale të Demarkacionit (të nënshkruar para më shumë se dy vjetësh) ta dërgojë në Kuvend. Bashkë me të Qeveria ka vendosur që në Parlament ta nisë edhe raportin përfundimtar të Komisionit të Ri Shtetëror për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi (të drejtuar nga Shpejtim Bulliqi). Kjo pasi gjatë ditës së djeshme ky komision prezantoi para Qeverisë raportin final për vlerësimin e punës së Komisionit paraprak, me ç'rast konstatoi se Kosova humb territor nga versioni i tanishëm.

Haradinaj: Raporti i komisionit kredibil, i hartuar nga profesionistët

Por pavarësisht këtyre, krejt në fund të kësaj kabineti qeveritar miratoi raportin e Komisionit të ri bashkë me Mar-



FOTO: LAURA HASANI

aktuale të Demarkacionit. Me këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj bëri të ditur se këto materiale do t'i dërgohen Kuvendit në vijim. "Konstatoj që Marrëveshja për Shënjimin e Kufijve dhe raportimi i Komisionit Shtetëror i kalojnë për shqyrtim Parlamentit të Kosovës", deklaroi Haradinaj. Ndërkohë, pas mbledhjes së Qeverisë Haradinaj ka vlerësuar se raporti i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit është kredibil, i hartuar nga njerëz profesionistë. Sipas tij, ky raporton vërteton pretendimet e deritashme se Kosova me versionin e tanishëm humb territor.

Shefi i ekzekutivit më tej ka thënë se ky komision ka vërtetuar se territori i Kosovës është deri në Kullë. "Komisioni Shtetëror e ka argumentuar fuqishëm parimin uti possidetis juris, me çka dëshmohet se deri në Kullë dhe në Zhlep territori është menaxhuar nga Kosova. Vetëm 17% e territorit të Malit të Zi, deri më 2013-ën, është përfshirë në regjistrat kadastralë të kësaj republike", ka shtuar ai.

Thaçi fton deputetët që ta votojnë versionin aktual të Demarkacionit

Pavarësisht kryeministrit presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ftuar deputetët që ta votojnë versionin aktual të Marrëveshjes së Demarkacionit, pavarësisht se Komisioni ka konstatuar se sipas këtij versioni Kosova ka humbur territor. "E mirëpres dhe përgëzoj Qeverinë e Republikës së Kosovës për vendimin e sotëm për ta proceduar për ratifikim në Kuvendin e Republikës së Kosovës Marrëveshjen për Shënimin e Vijës Kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Dua të besoj në vullnetin politik dhe shtetëror të përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve, por njëkohësisht ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, pavarësisht përkatësisë partiake të tyre, që të jenë të bashkuar në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje ndërshtetërore", ka thënë ai. Kjo meqë, sipas të parit të shtetit, miratimi i kësaj marrëveshjeje çon edhe deri te liberalizimi i vizave për Republikën e Kosovës. "Ratifikimi i Marrëveshjes për Shënimin e Vijës Kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi i jep fund izolimit të vendit tonë, duke mundësuar heqjen e regjimit të vizave, por edhe e forcon subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit tonë", ka shtuar ai.

Thaçi më tutje ka thënë se me vendimin që Demarkacioni të shkojë në Kuvend marrin fund të ashtuquajturat "debatet shterpë akademike" (se kinse Kosova humb territor).

Veseli: Marrëveshja duhet të kalojë, vota jonë është pro

Nga ana tjetër, pavarësisht se kryeministri Haradinaj (AAK) është deklaruar kundër Marrëveshjes aktuale, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se partia e tij do ta votojë versionin aktual të Marrëveshjes së Demarkacionit. "Marrëveshja duhet të kalojë dhe vota jonë është pro, siç e kemi thënë në vazhdimësi.

Izolimi i qytetarëve tanë duhet të marrë fund. Presim nga Bashkimi Evropian liberalizimin e vizave", ka deklaruar Veseli pas kësaj. Po ashtu i pari i PDK-së ka përshëndetur vendimin e Qeverisë që këtë Marrëveshje ta dërgojë në Kuvend. "Përshëndes vendimin e Qeverisë për ta sjellë në Kuvend Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës është i qartë", ka theksuar ai.

Haxhiu: Në Kuvend do të duhej të dërgohej vetëm raporti, Marrëveshja të tërhiqej

Ndërkaq deputetja e lëvizjes "Vetëvendosje", Albulena Haxhiu, duke folur rreth vendimit të Qeverisë që ta dërgojë në Kuvend Marrëveshjen dhe raportin e Komisionit, ka thënë se LVV-ja nuk e ka të qartë këtë vendim. Porse, sipas saj, nëse Qeveria ka vendosur që versionin aktual dhe raportin t'i dërgojë bashkë në Kuvend, atëherë një gjë e tillë nuk do ta pranohet. "Ne ende nuk kemi informacione të qarta se çka ka dërguar Qeveria në Kuvend. Nuk e kemi të plotë raportin e këtij komisioni, ndonëse jemi të bindur, ashtu edhe kemi dëgjuar, që është vërtetuar që Kosova ka humbur territor me Marrëveshjen e 6-të gushtit 2015. Ajo çfarë ne nuk e kemi të qartë është se a e ka dërguar Qeveria projektligjin që përmban Marrëveshjen aktuale të versionit të Demarkacionit. Nëse Qeveria së bashku me raportin e Komisionit ka dërguar edhe Marrëveshjen aktuale, atëherë kjo është një gjë e papranueshme për lëvizjen 'Vetëvendosje'", ka deklaruar ajo, duke shtuar se kjo marrëveshje do të duhet të tërhiqej nga kryeministri.

Kjo meqë në Kuvend do të duhej të nisej vetëm raporti i Komisionit Shtetëror. "Do të duhej të dërgohej vetëm raporti, që ai raport të diskutohej edhe një herë, në mënyrë që deputetët që kanë ende mëdyshje për këtë gjë të binden që Hashim Thaçi ka nënshkruar një marrëveshje që fal territor", ka theksuar ajo.

Megjithatë, Haxhiu e ka konsideruar si lajm pozitiv konstatimin e raportit të ri, meqë me një gjë të tillë konstatohet sërish se Kosova humb territor nga Marrëveshja aktuale.

"Pra, ne si LVV presim që ta marrim raportin dhe është lajm i mirë që është vërtetuar me fakte edhe një herë që Kosova ka humbur territor. Po them lajm i mirë për faktin se sot ende dëgjoj zyrtarë të PDK-së që thonë të votohet Marrëveshja që fal territor", ka shtuar ajo.

Mustafa: Asgjë të re për kufirin

Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, njëherësh kryetar i LDK-së, ka thënë se nuk ka pasur asgjë të re nga raportimi i Komisionit. "Nuk kemi parë asnjë të re, asnjë të gjetur, përpos atyre që janë thënë edhe përpara", ka deklaruar ai. Mustafa më tej ka thënë se ende nuk është e qartë se çka kryeministri Haradinaj ka nisur në Kuvend. "Është dashur që të dihet se a po i dërgohet Kuvendit Ligji mbi Ratifikimin e Marrëveshjes, i nënshkruar në vitin 2015, apo po i dërgohet diçka tjetër. Sepse nuk mund të përzihen një raport i Komisionit me Marrëveshjen që është nënshkruar me Malin e Zi", ka theksuar Mustafa, duke thënë se pret sqarim nga ana e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Baraliu: Miratimi i raportit nga Qeveria, lajm i mirë

Nga ana tjetër njohësi i çështjeve politike, Mazllum Baraliu, raportin e Komisionit të Ri e ka cilësuar si një përpjekje serioze të anëtarëve, të cilët e kanë dëshmuar edhe më parë që Kosova ka humbur territor nga versioni i tanishëm. "Çdo qytetar që gjykon në esëll e di nga ajo që është bërë e njohur nga shkrimet dhe studimet se Kosova ka humbur territor pas atij Komisionit të mëhershëm", është shprehur ai. Baraliu më tej ka thënë se miratimi i Qeverisë për raportin në fjalë paraqet një lajm të mirë. Andaj deputetët duhet të mendojnë para se ta votojnë Marrëveshjen aktuale (kur të kalojë në Kuvend). "Tash mbetet Kuvendi që ta analizojë mirë, duhet që secili deputet i Kuvendit të mendojë me përgjegjësi se si po voton. Është lajm i mirë që Qeveria ka miratuar raportin, që raporti ka konstatuar lëshimet e atij Komisioni të mëparshëm dhe ka dhënë rekomandimet e tij", ka shtuar ai.

Maliqi: Kundërshtitë ndaj demarkacionit, të pabazuara

Pavarësisht tij, analisti politik Agon Maliqi ka thënë se kundërshtimet ndaj procesit të demarkacionit kanë ardhur si rezultat i motiveve politike. Sipas tij, kryeministri Haradinaj tashmë e ka të vështirë të largohet nga qëndrimi i tij kundërshtues. "Tani Kuvendit i mbetet të vendosë mes gjykimit të këtij Komisioni dhe fjalës së dy komisioneve të tjera (njëri prej të cilëve ndërkombëtar). Mendimi im është se kundërshtitë ndaj procesit nuk kanë qenë të bazuara në logjikën e së drejtës ndërkombëtare dhe se kundërshtia ka nisur më shumë për motive të politikës së përditshme, prej të cilave tani Haradinaj me gjasë e ka të vështirë të tërhiqet", ka deklaruar ai për "Zërin". Maliqi më tej ka thënë se deputetët e Kuvendit duhet që sa më shpejt ta miratojnë Demarkacionin. Kjo meqë Kosova nuk meriton të izolohet për një kauzë të paqenë.


FOTO: DRITON BUBLAKU

Tahiri: Prioritet, luftimi i korrupsionit

Prishtinë. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, tha sot se luftimi i korrupsionit do të jetë prioritet gjatë punës së tij në krye të kësaj Ministrie. Duke shfrytëzuar "Javën kundër korrupsionit", e cila filloi të hënën me disa aktivitete nëpër Kosovë, Tahiri tha se shënimi i "Javës së korrupsionit" ka gjetur Kosovën më të mobilizuar "për t'i dhënë përgjigjen e duhur kësaj dukurie negative që po mban peng të ardhmen evropiane të shtetit të Kosovës". "Në kuadër të këtyre përpjekjeve si ministër i Drejtësisë kam marrë masa që kontribuojnë ekskluzivisht në këtë drejtim. Procedimi për miratim i Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe Prokurorit të Shtetit, miratimi në Qeveri i Koncept-Dokumentit për Suspendimin e Zyrtarëve në rast akuze për korrupsion, ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal, si dhe rishikimin e mandatit të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe procesit të deklarimit të pasurisë janë vetëm disa masa direkte të kësaj natyre", ka shkruar Tahiri. Ai zotohet se do të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, rezultatet e së cilës do të ndikojnë në rritjen e besimit të qytetarëve në institucione. Kosova radhitet lart në listat e organizatave ndërkombëtare për praninë e korrupsionit në institucione publike. Në kuadër të "Javës kundër korrupsionit 2017", Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe "Columbus" kanë mbajtur një konferencë për medie me temën "Ora kundër korrupsionit", me ç'rast trajtuan disa raste të mëdha, të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje. Përfaqësuesit e këtyre dy organizatave joqeveritare paralajmëruan se të martën do të kërkojnë përgjigje nga prokurorët e nga personat me të cilët janë marrë me trajtimin e këtyre rasteve.

Betim Musliu, nga IKD-ja, tha se afera e përgjimeve e njohur si "Pronto" është afera më e madhe, mirëpo kjo aferë asnjëherë nuk është futur në listën e rasteve që duhet të trajtohen si prioritet. "Afera 'Pronto' është afera e përgjimeve përmes së cilës është dëshmuar një aferë korruptive dhe kjo aferë është në fazën e hulumtimit. Afera 'Pronto' nuk është në rastet e top-shënuara që trajtohen me prioritet absolut. Afera 'Pronto' nuk është trajtuar me prioritet edhe kjo dëshmon edhe joseriozitetin në zgjedhjen e rasteve", tha Musliu. Ndërsa rastin e "Falsifikimit të diplomës" nga kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, e prezantoi Ehat Miftaraj. Ai tha se prokurori që e ka trajtuar këtë rast ka kryer veprime pa pasur një vendim nga gjykata për hapje të hetimeve, duke bërë shkelje. "Prokurori Munishi ka sekuestruar dokumente me vendim të tij. Prokurori ka marrë në pyetje dëshmitarë si nga Kosova, ashtu edhe nga Serbia pa pasur një vendim për hapje të hetimeve. Në mënyrë që të zbulohet e vërteta është dashur të bëhet ekspertizë e dokumenteve", tha Miftaraj. Edhe instituti "Columbus" prezantoi dy raste lidhur me korrupsionin. Saranda Rama e cila prezantoi rastet tha se do të mundohen të marrin përgjigje në pyetjet për këto raste nga akterët e përfshirë edhe pse Policia ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë.

Dënohet me kusht

Gjakovë. Gjykata Themelore në Gjakovë e ka dënuar me shtatë muaj burgim me kusht të akuzuarin për "Keqpërdorim të detyrës apo të autoritetit zyrtar", Luan Kleçka. Mirëpo, dënimi me burgim ndaj tij nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen vepër të re penale brenda dy vjetësh. Kleçka nga kjo gjykatë është gjetur fajtor se në cilësinë e punëtorit të sigurimit nga sporteli i Postës së Kosovës, Dega në Rahovec, kishte marrë zarfin me para në shumë prej rreth 500 eurosh. Po ashtu, tashmë i dënuari Kleçka është obliguar që të dëmtuarës, Postës së Kosovës, t'ia kompensojë shumën prej 465.17 eurosh, në afatin prej 30 ditësh, në të kundërtën dënimi i kushtëzuar do të shndërrohet në dënim me burg. Megjithëse, në shqyrtimin fillestar, që ishte mbajtur më 29 shtator të këtij viti, i akuzuari Luan Kleçka ishte deklaruar i pafajshëm për akuzën që i vihej në barrë, këtë të hënë, kur edhe është hapur shqyrtimi gjyqësor dhe para se të shpallej aktgjykimi ndaj tij, ai e ka pranuar fajësinë. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit Ali Uka, i akuzuari Kleçka ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe se e pranon fajësinë, duke thënë se veprimin e kishte ndërmarrë nën ndikimin e alkoolit, me ç'rast ka shprehur keqardhje dhe se zotohet se do të bëjë kompensimin e palës së dëmtuar, ka raportuar "betimiperdrejtesi.com". Mbrojtësi i tij, avokati Ndrecë Dodaj, ka deklaruar se pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka kërkuar nga gjykata që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh edhe kërkesën e prokurorit që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, pastaj gatishmëria e të pandehurit për kompensimin e dëmit të shkaktuar për palën e dëmtuar. Këtë pranim të fajësisë nuk e ka kundërshtuar as prokurori Uka, i cili ka theksuar se ky pranim është bërë me vullnet të lirë dhe se e ka mbështetjen edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Prokurori i ka propozuar gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovojë dhe gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të merren rrethana lehtësuese. Përfaqësuesi i të dëmtuarës, Posta e Kosovës, Ragip Hoxhaj, ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurorit, i cili ka shtuar se mbetet pranë kërkesës pasurore-juridike. Sipas aktakuzës, Luan Kleçka dyshohet se me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ka keqpërdorur detyrën zyrtare.

Lirohet nga aktakuza ish-drejtori i shkollës

Gjilan. Gjykata Themelore në Gjilan, të hënën, e ka liruar nga akuza për "Keqpërdorim të detyrës zyrtare" ish-drejtorin e Shkollës Ekonomike në fshatin Vërbvoc të komunës së Kllokotit, Bozhidar Dejanoviq. Trupi gjykues, i kryesuar nga Zyhdi Haziri, ka vlerësuar se veprimi i të akuzuarit në bazë të provave të cilat janë ofruar për shqyrtim mund të konsiderohet si shkelje administrative, mirëpo jo edhe si përgjegjësi penale, duke shtuar se nuk është provuar se i akuzuari ka përfituar në ndonjë mënyrë nga ky veprim. Paraprakisht, prokurori i rastit Shaban Spahiu ka mbetur pranë aktit akuzues dhe ka kërkuar nga trupi gjykues të shqiptojë dënimin meritor për veprën, e cila i vihej barrë të akuzuarit, pasi sipas tij, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga deklaratat e dëshmitarëve është vërtetuar se Dejanoviq ka kryer këtë vepër penale. I akuzuari Dejanoviç në seancat e këtij shqyrtimi gjyqësor ka deklaruar se personat të cilët kanë marrë paga nga buxheti i Kosovës kanë qenë të punësuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në mënyrë të rregullt dhe mësimi në shkollat serbe, sipas tij, është zhvilluar paralelisht nga të dy sistemet ku në klasë para nxënësve kanë prezantuar mësimdhënësit nga sistemi i Serbisë dhe ai i ka pranuar nga Ministria e Arsimit, sipas sistemit të Kosovës. Sipas tij, këta mësimdhënës nuk kanë poseduar ditar klase dhe se nuk kanë aplikuar ndonjë formë tjetër në mënyrë që të mbahet evidencë për mbajtjen e orëve mësimore. Prokuroria Themelore në Gjilan kishte akuzuar të pandehurin Bozhidar Dejanoviq se në cilësinë drejtorit të Shkollës së Mesme Ekonomike, në fshatin Vërbovc, komuna e Kllokotit, u ka mundësuar tre mësimdhënësve realizimin e të ardhurave mujore pa mbajtur orët mësimore, raporton "betimiperdrejtesi.com". Sipas Prokurorisë, Dejanoviq ka qenë në dijeni se këta mësimdhënës nuk kanë mbajtur asnjë orë mësimore për periudhën janar 2013 deri shkurt 2014, ashtu siç kanë qenë të obliguar sipas kontratës së punës, por megjithatë ka lejuar një gjë të tillë. Me ç'rast, sipas aktakuzës, dëmi i shkaktuar Komunës së Kllokotit është në vlerë prej 7,286.24 euroah.

Bota

“Mirë se vini në Eurozionin e madh!”



Lodhja ekzistenciale e qytetërimit evropian ka rrënjë shumë të thella që shkojnë thellë në gjuhën tashmë të fryrë të të drejtave të njeriut, avokatët e të cilave dhe burokratët janë bërë priftërinjtë e rinj dhe në nënvlerësimin e rreziqeve të paraqitur prej ideologjive ekstremiste

Trupi politik evropian është i sëmurë, por, paralajmëron John Bew, profesor i King’s College në Londër në librin e tij “Eurozioni i madh”, nuk ka konsensus as për diagnozën dhe as për kurën. Ndërkohë mbi Evropë “vërtitet një hije”, hija e Osvald Spenglerit. Shkrimet e historianit të madh gjerman, i cili mes viteve 1918 dhe 1924 botoi “Muzgu i perëndimit”, po rikthehen në qendër të debatit kulturor. I gjithë mendimi perëndimor është i përshkuar prej ndikimit të Spenglerit, që është edhe paradigma e tre librave, të cilët përshkruajnë të pandërgjegjshmen e kontinentit evropian.

Douglas Murray, Bill Emmott dhe Eduard Luce ofrojnë, mes perspektivave të ndryshme, diagnozën e tyre për sëmundjen evropiane. Murray, autori i “Vdekja e çuditshme e Evropës: Imigrimi, identiteti, islami” është më kontroversi, ndër të tre. Evropa po vuan nga një humbje e domethënies dhe peshës që e bën atë të brishtë dhe të dobët përballë rivalëve. Për të përshkruar këtë ndjenjë lodhjeje nga historia, përveç spenglerizmit, Murray e hap me një citim të fuqishëm të romanit të famshëm të Stefan Cvajgut, “Bota e djeshme: kujtimet e një evropiani”. Autori me origjinë austriake, në vitin 1942 shkruante: “Ndiej që Evropa, në gjendjen e vet të tronditjes, e ka kaluar dënimin me vdekje”. Bill Emmott, ish-drejtor i “The Economist”, në librin “Fati i Perëndimit: Beteja për të shpëtuar idenë më të suksesshme politike në botë”, ngre pyetjen se çfarë do të mendonte Spengleri nëse do të transportohej në kohë në vitin 2017 dhe sipas gazetarit britanik, ndoshta do të thoshte gjëra që mbajnë aromë të “të djathtës alternative”, mbi pamjaftueshmërinë e demokracisë si sistem qeverisjeje, mbi krenarinë e kotë që na shpie të ndërhyjmë jashtë dhe mbi dobësinë që na shpie të dështojmë në po këta vende ku ndërhyjmë. Por Spengleri me siguri do të kërkonte përgjigje për krizën demografike të shkaktuar nga një shoqëri gjithnjë e më e plakur, për përparimet teknologjike gjithmonë e më të shpejta. Autori i tretë i cituar është Eduard Luce, editorialist i “Financial Times” dhe ish-hartues i fjalimeve për Larry Summers gjatë administratës Clinton. Në librin e tij “Tërheqja e liberalizmit perëndimor”, gazetari preferon të sjellë një bashkëkohës të Spenglerit, Thomas Mannin, i cili ashtu si filozofi ankohej për ata që kultivonin një lloj “dhembshurie për humnerën”. Pas një reflektimi bindës, ai shkruan se prishja e kontratës sociale të perëndimit, diskreditimi i meritokracisë dhe kolapsi i lëvizshmërisë sociale, kanë sjellë ngecjen e klasës së mesme. Luce i druhet Donald Trumpit dhe beson se është në gjendje të hedhë në erë, të qëllojë apo të bombardojë, për shkak të një gabimi strategjik apo një postimi të gabuar në “Twitter”. Në perëndim, frikët e dekadencës dhe paralizës manifestohen horizontalisht, përgjatë të gjithë spektrit politik, dhe vertikalisht, përgjatë hierarkisë sociale. Të tre autorët bien dakord mbi fakti se diçka nuk ka funksionuar nga pikëpamja ekonomike dhe politike, por ka me të vërtetë shumë pak konsensus mbi diagnozën dhe kurën. Dikush kërkon opioidë, në formën e një përshtatjeje të shpejtë politike, të tjerë rekomandojnë rikthimin tek parimet fillestare, për të mbajtur fort timonin e varkës shtetërore, përballë deteve me tallaze që gjenden përpara. Liberalët sillen si konservatorë, në përpjekjen për të mbijetuar shtrëngojnë dhëmbët përballë surprizave të hidhura që u rezervojnë zgjedhësit. Konservatorët, nga ana e tyre, bëhen radikalë dhe vetëshpallin “shkëputjen e domosdoshme”, e cila dëgjeneron në një status quo, që do i shpjerë të gjithë drejt shkatërrimit. Mes autorëve të cituar, Murray është më i guximshmi. Me kurajë intelektuale trajton temën e vendimeve të marra kundër terrorizmit. Nëse Evropa po vdes, kjo po ndodh sepse ajo po vetëvritet, sepse ka vendosur të dështojë sa i përket kontrollit të imigrimit masiv, duke shpërfillur vlerat e saj themelore. Evropa, e lindur nga kultura judaiko-kristiane, greke, romake dhe nga rilindja, është duke u martirizuar duke refuzuar vlerat e veta. Lodhja ekzistenciale e qytetërimit evropian ka rrënjë shumë të thella, që shkojnë thellë në gjuhën tashmë të fryrë të të drejtave të njeriut, avokatët e të cilave dhe burokratët janë bërë priftërinjtë e rinj, dhe në nënvlerësimin e rreziqeve të paraqitur prej ideologjive ekstremiste. Kur Angela Merkeli u hapi dyert refugjatëve sirianë në vitin 2015 e bëri prej pendesës dhe një lloj shlyerjeje ndaj të kaluarës gjermane. Instinkti fisnik i lëvizjes së kancelares gjermane avulloi brenda një kohe të shkurtër, popullariteti i Merkelit ra, Gjermania filloi të vuajë peshën e të ardhurve dhe Alternative fuer Deutschland u rrit në sondazhe dhe mbështetje elektorale. Rasti emblematik i Gjermanisë reflektohet në të gjithë realitetin evropian dhe Brexit është pasoja e drejtpërdrejtë e po këtyre problemeve. Sipas Murrayt, Evropa ka humbur terrenin e saj kulturor. Edhe arti ka nisur një rënie progresive në parazitizëm dhe mungesë sinqeriteti. Luce dhe Emmot paraqesin si sfidë ambicioze, atë të studimit të perëndimit, për ta rikthyer në binarë. Ashtu si Murray, besojnë se sistemi liberal-demokratik perëndimor po shembet nën peshën e kontradiktave të veta, por këmbëngulin se armiku është mbi të gjitha i brendshëm. Sa i përket shpëtimit të projektit evropian që lind nga një aspiratë për hapje, por që megjithatë ka harruar rolin e vet si “argjinaturë” ndaj tribalizmit, Emmott është ai që beson më shumë në një rilindje. Qasja e Emmanuel Macron, për gazetarin, është më e matur në krahasim me atë të Merkelit. Nuk rekomandon “më shumë Evropë”, por më shumë bashkëpunim. Optimizmi i tij është pa dyshim i mirëpritur, por, siç vë në dukje John Bew, është si të luftosh një luftë të re me armët e vjetra. Ushtri të këtij lloji janë të nevojshme për të rikërkuar shpirti evropian, por siç do të mendonte Spengleri, këtij shpirti i mungon ende diçka.

K



ART

Kur kam qenë 5 vjeçe, kam pas një gotë porcelani dhe sa herë që kam dashur të pi diçka kam pi vetëm prej asaj gote. E veçanta e kësaj gote ka qenë, sepse sa herë që e kam mbajtur gotën në dorë, e kam dëgjuar melodinë e "Fur Elise", e që për mua si fëmijë ka qenë diçka e veçantë. Kanë kaluar shumë vite prej asaj kohe të fëmijërisë, mirëpo unë sa herë e dëgjoj më kujtohen shumë momente të mira prej asaj kohe.

Kënga që s'e ka përfunduar misionin



Këtë javë në rubrikën "Rrëfej përmes muzikës" prezantojmë aktoren Semira Latifi. Ajo na flet për këngët e saj të preferuara. Aktorja deklaron se muzika zë vend shumë të rëndësishëm në jetën e saj dhe se i dëgjon pothuajse të gjitha zhanret.

"Të gjithë kemi këngët tona të preferuara. Mund të jenë këngë që i kemi dëgjuar kur kemi qenë fëmijë, ose këngë që na ngjallin një kujtim, por mendoj që jo domosdoshmërisht duhet të kemi arsye ta pëlqejmë atë këngë. Ndonjëherë mund të na pëlqejë edhe pa ndonjë arsye të fortë, thjeshtë na bën të ndjehemi mirë", thotë Latifi, duke shtuar se një këngë e mirë është ajo ku teksti dhe melodia bashkohen fuqishëm dhe provokojnë emocion.

Bethoven- "Fur Elise"

Është njëri ndër kompozimet më të njohura të Ludwig Van Bethowen, i cili u publikua 40 vjet pas vdekjes së kompozitorit. Kur kam qenë 5 vjeçe, kam pas një gotë porcelani dhe sa herë që kam dashur të pi diçka kam pi vetëm prej asaj gote. E veçanta e kësaj gote ka qenë, sepse sa herë që e kam mbajtur gotën në dorë, e kam dëgjuar melodinë e "Fur Elise", e që për mua si fëmijë ka qenë diçka e veçantë. Kanë kaluar shumë vite prej asaj kohe të fëmijërisë, mirëpo unë sa herë e dëgjoj më kujtohen shumë momente të mira prej asaj kohe.

Spice Girls-"Wannabe"

"Spice Girls" kanë qenë pjesë e pandashme e imja. Të gjitha këngët i kam ditur, sepse i kam dëgjuar shumë. Kemi qenë 5 shoqe të pandashme dhe çdo herë i kemi ushtruar koreografitë dhe këngët e tyre. Kështu, çdo ditëlindje ose festë që kemi organizuar si fëmijë, ne e kemi pasur kohën tonë të performancës.

"The Remigrant" i Astrit Alihajdarajt në Vjenë

1

"The Remigrant" është filmi i cili e sjellë për herë të parë në rolin e regjisorit aktorin e njohur Astir Alihajdari. Ky film flet për shumë tema në të njëjtën kohë.

Filmi kosovar "The Remigrant", me regji të Astrit Alihajdarajt, është filmi prej 18 minutash, i cili do të prezantohet më 8 dhjetor në "This Human World Film Festival" të Vjenës. "The Remigrant" është filmi i cili e sjellë për herë të parë në rolin e regjisorit aktorin e njohur Astir Alihajdari. Ky film flet për shumë tema në të njëjtën kohë. Migrimi, harmonia në familje, edukimi i fëmijëve, janë disa nga temat që jetësohen në këtë film. Bashkimi (50 vjeçar) dhe djali i tij Besniku (17 vjeçar) ndajnë të njëjtin fat. Të dy detyrohen të lënë shtëpitë e tyre në një moshë shumë të re. Babai duhej të largohej nga lufta në Kosovë dhe shkon në Austri, kurse tani, pas 17 vjetësh në Vjenë, djali duhej të kthehej në Kosovë me dëshirën e babait të tij. Ky kthim i vë ata në provën e rritjes. Dëshira e fortë për vendin e fëmijërisë i lidhë, por në të njëjtën kohë edhe i ndan babanë dhe djalin. Pjesë e kastës së "The Remigrant" janë disa nga emrat më të dëshmuar të aktrimit në Kosovë, si Leze Qena, Ilire Vinca, Veton Osmani, Florist Bajgora, etj.



Amy Winehouse-"Rehab"

"Rehab" është kënga e parë që e kam dëgjuar prej Amy Winehouse, pastaj kjo këngëtare u bë pjesë e pandashme e imja. Për një kohë shumë të shkurtë kam arritur që ta adhuroj çdo këngë të saj. Amy-in e kam dëgjuar për stilin e saj në përzierjen e zhanrit, ekspresivitetin përmes zërit të saj të thellë dhe teksteve të saja që për mua kanë qenë të veçanta.

Cesaria Evora-"Ingrata"

Këngëtare me fame nga Cape Verde, e njohur ndryshe si "Diva këmbëzbathur" e po ashtu është e njohur edhe si mbretëresha e mornas - zhanër i muzikës dhe vallëzimit nga Cape Verde. Ka qenë aktive prej viteve 1957-2011. Këngët e saj i dëgjoj atëherë kur kam dëshirë që të ndihem e qetë. Tekstet e saja kanë shumë kuptim, madje disa prej tyre kanë histori që ndërlidhen me vendin e saj të lindjes, me popullin dhe me fëmijërinë e saj. Kënga "Ingrata" flet për vitet e 40'ta dhe 50'ta kur shumë njerëz është dahur që ta linin vendin e tyre të lindjes për shkak të regjimit portugez.

Maria Callas-"Ave Maria"

Një nga sopranot me influencë gjatë shekullit të XX, të cilën shumë kritikë e vlerësuan teknikën e saj, zërin e gjerë dhe interpretimet dramatike. Këtë këngë e kam dëgjuar shumë kur ishim duke e punuar shfaqjen e diplomës. Në atë kohë kisha rolin e Martha Washington dhe kërkoja shumë informacione për kohën kur ka jetuar, mënyrën e jetës etj. Gjatë provave, profesori im i aktrimit, Luan Jaha, na e propozoi "Ave Marian" që ta dëgjonim dhe tani kur e dëgjoj kam shumë kujtime që më rikthejnë në atë fazë aq të mirë të studimeve.

Bob Marley

Pa dyshim që Bob Marley njihet si njeri ndër figurat më të rëndësishme të shekullit XX. Shërbeu si ambasador i muzikës reggae dhe shiti mbi 20 albume. Me tekstet e tij ka inspiruar të tjerët për të ndjekur një stil jetese të paqes dhe harmonisë. Me aq shumë këngë të mira është shumë e vështirë që të zgjedhësh më të mirën prej tij. Këngët që i dëgjoj më së shumti janë: "No Woman No Cry", "Redemption Song", "Three Little Birds" dhe "Red Red Wine".

Billie Holiday-"Strange Fruit"

"Strange Fruit" është një këngë proteste me rëndësi të qëndrueshme. Vargjet e kësaj kënge simbolizojnë brutalitetin dhe racizmin e praktikës së linçimit në Amerikën e Jugut. Ishte hera e parë që një artist me ngjyrë të këndojë një këngë me një tekst kontraverz. Kjo këngë është shndërruar në simbol të racizmit, vuajtjes, dhimbjeve të përjetuara në SHBA.

"Amazing Grace"

John Newton ish kapiten i anijes së skllevërve, e shkroi këtë këngë në vitin 1772. Qëllimi i tij ishte që të ndalej tregtia e skllevërve. Tashmë është shndërruar në himn, i cili këndohet nga të gjitha racat. Po ashtu një këngë proteste e cila lidhet me të drejtat civile. Fatkeqësisht trafikimi i qenieve njerëzore dhe robëria ende ekziston, andaj ndonjëherë mendoj që kjo këngë ende nuk e ka "përfunduar plotësisht" qëllimin e saj.

Reamonn- "Tonight"

Ajo çka e bën të veçantë këtë këngë për mua është thjeshtësia dhe pastërtia që e përmban teksti. Mendoj që këtu gjen vend shprehja "Less is more". Është prej këngëve të mia të preferuara dhe sa herë që e dëgjoj vazhdoj ta pëlqej më shumë. (Fotografitë: Brigitte Hamadey)



Diella i jep shpresës statusin e jetës universale

2

Si të gjithë poetët që e besojnë poezinë si një mision jetëgjatë dhe që e ndjenë se krijuesi është vetë gjuha e tij, ajo e ka të lindur këtë vetëdije dhe instiktin e të ardhmes së saj, duke mos rënë pre e tekave të modës kalimtare, shkrimit në dialekt, po duke përfituar prej tij atë bukuri që ia bie si pasuri jetëdhënëse për letërsinë", konstaton Petrit Ruka

Këto ditë Diella Çitaku bëri promovimin e dy librave të saj me poezi, "Mjegulla ka sy" dhe "Brengë e uritur". Për poezinë e Diellës kanë folur dhe kanë shkruar edhe krijuesit si Petrit Ruka dhe Fatmir Minguli. Duke lexuar librin e Diellës, "Mjegulla ka sy", të fryn në shpirt një erë kënaqësie poezi pas poezie dhe kjo ndodh sepse e ndjen që po lexon një shpirt që flet sinqerisht dhe që endet gëzimeve dhe pështjellimeve të saj emocionale për të na i prurë ngjeshur dhe poetikisht me një thjeshtësi dhe thellësi mençurie të admirueshme, konstaton Petrit Ruka, i cili duke analizuar poezinë "Ikën fjalët", shprehet kështu: "Ka diçka kaq të bukur dhe magjike në këtë përjetim të Diellës për fjalën gjatë aktit të krijimit, diçka nga ajo dhembje e pafundme në përfytje me fjalën, që sapo shkruhet muroset në një fjali, si të vdiste vërtetë. Ti do që ajo të mos vdes e të iki prej teje sapo u shkrua, siç ndodh gjatë krijimit. Ti e do atë ende të gjallë dhe në buzë, të lëvizshme dhe me përpjekjen për ta bërë ende sa më vezulluese. Por e shkruar, tashmë ajo është ndarë nga ty, ka fituar lirinë e saj, është murosur, duke të lënë pengun e pendimit, se mund ta kishe rreshtuar më mirë në këtë "mur" vargjesh. Dhe ja, tani, aty në vargun e fundit tunden xhindet..."

Motiveve të dashurisë, Diella i qaset me elegancën dhe pafundësinë e thellësive gati misterioze, që e gjen më dendur vetëm në poezinë femërore, kur talenti arrin ta përcjell tek fjala këtë bukuri marramendëse: "Mëngjeset humbin virgjërinë/ashtu tek treten ditëve pa emër/vesa shtron dashuri në bar,..." Dhe vetëm një zemër gruaje mund ta nis ditën me vesën që shtron dashurinë në bar si të shtronte një shtrat nusërie e ta mbyll atë krejt me të kundërtën e këtij gazmendi, me dhembjen që ditë-jeta i bie njeriut drejt e në zemër. Poezia e saj vjen përmes një gjuhe të bukur e të maturuar, një shqipe e shkëlqyer letrare, që ia shton edhe më shumë vlerat librit. Si të gjithë poetët që e besojnë poezinë si një mision jetëgjatë dhe që e ndjenë se krijuesi është vetë gjuha e tij, ajo e ka të lindur këtë vetëdije dhe instiktin e të ardhmes së saj, duke mos rënë pre e tekave të modës kalimtare, shkrimit në dialekt, po duke përfituar prej tij atë bukuri që ia bie si pasuri jetëdhënëse për letërsinë.

Poezia e Diella Çitakut është meditative, ku meditimi sillet si një teori mbi abstrakten e dukshme dhe të padukshme, Është një poezi që ajo e polemizon vetëm me veten e saj duke qenë në një pritje të vazhdueshme. Kjo pritje duket shumë qartë në poezinë "Mirazhi i një pritje" e cila është një poezi emblemë ku konceptet filozofike marrin jetë, gjallohen duke i dhënë pritjes, statusin e shpresës universale", vlerëson Fatmir Minguli.

"Diella Çitaku ka hequr dorë nga poezitë plot patetizëm të shfrenuar, ka hequr dorë nga poetizmi i bazuar në ngjarje të caktuara duke na sjellë një poezi shpirtërore, aq më tepër që është një poete grua. Poezia e saj është jo vetëm me boshte të qarta të mendimit, çka e bën atë krejt origjinale, por edhe romantika e figurat e guximshme artistike e vendosin këtë poezi në nivele shumë të larta. Poezia e Diella Çitakut është meditative, ku meditimi sillet si një teori mbi abstrakten e dukshme dhe të padukshme, Është një poezi që ajo e polemizon vetëm me veten e saj duke qenë në një pritje të vazhdueshme. Kjo pritje duket shumë qartë në poezinë "Mirazhi i një pritje" e cila është një poezi emblemë ku konceptet filozofike marrin jetë, gjallohen duke i dhënë pritjes, statusinë e shpresës universale", vlerëson Fatmir Minguli.



eurokoha

Një fundvit për ta mbajtur mend! Antalya 2018

Fluturim direkt
Prishtinë ✈ Antalya ✈ Prishtinë

Nisja: **29.12.2017**
Kthimi: **02.01.2018 - 4 net e 5 ditë**

Ultra All Inclusive
Festa e Vitit të Ri me darkë solemne dhe program festiv dhe argëtues.

Në çmim përfshihen

- ✓ Bileta e aeroplanit Prishtinë ✈ Antalya ✈ Prishtinë
- ✓ Taksat e Aeroportit
- ✓ Transferi: Aeroport-Hotel-Aeroport
- ✓ 4 net akomodim në hotel, Ultra All Inclusive
- ✓ Darka solemne e Vitit të Ri

Për informata dhe rezervime
Tel. 038 235 235
eurokoha.eu

SPORT

Luhet për "jetë a vdekje"
Faqe 14



Futboll Maqedonia bie në duart e Shkëndijës 12

Futboll E treta e vërteta 13

Basketboll Bashkimi e do fitoren e dytë 12



Bëhet në Drenas

Qeveria e Kosovës i ka mëshuar vulë lokacionit të ndërtimit të Stadiumit Nacional. Të hënën është hequr çdo dilemë, pasi u vendos përfundimisht që njëri prej projekteve më të rëndësishëm pasluftës të ndërtohet në Drenas, edhe pse fillimisht ishte vendosur që ai të bëhet në Prishtinë. Stadiumi Nacional do të ndërtohet në një hapësirë prej 25 hektarësh në Sankoc të Drenasit, 14 kilometra larg Prishtinës. Punimet pritet të nisin në vitin 2018

Sport



BASHKIMI E DO FITOREN E DYTË

Bashkimi do ta kërkojë sonte fitoren e dytë për këtë sezon në Ligën Ballkanike. Skuadra prizrenase do të përballet me ekipin BC Akademik Bultex 99, në ndeshjen që do të zhvillohet në palestrën e sporteve "Sezai Surroi" në Prizren dhe që do të fillojë në orën 19:30. Ekipi portokalli momentalisht gjendet në pozitën e gjashtë në tabelë me një fitore e dy humbje, duke grumbulluar katër pikë. Një fitore eventuale mund t'ia shtojë gjasat për ta kaluar fazën e grupeve.

@ Për më shumë kontakto në: sporti@zeri.info

Maqedonia bie në duart e Shkëndijës

Valon Konushevci

Futbolli i Maqedonisë ka rënë në duart e shqiptarëve. Është Shkëndija shqiptare ajo e cila tashmë e ka marrë dominimin e futbollit maqedonas, duke e përmbysur dominimin shumëvjeçar të gjigantit, Vardarit. Pjesa e parë e kampionatit maqedonas është mbyllur të dielën, ndërsa Shkëndija e ka marrë epitetin e kampiones vjeshtore. Falë investimeve të mëdha dhe politikave perfekte menaxhuese nga "Ecologu" i biznesmenit të famshëm shqiptar, Lazim Destani, ekipi tetovar "ka shkelur" gjithçka që i ka dalë përpara në sezonin vjeshtor, duke kryesuar e vetmuar dhe e pakonkurrencë në elitën maqedonase.

Shkëndija ka shkuar në pushim dimëror me 46 pikë të tubuara prej tetëmbëdhjetë ndeshjeve të zhvilluara, duke i regjistruar pesëmbëdhjetë fitore e një barazim dhe vetëm dy humbje. Skuadra kuqezi e ka lënë shumë prapa gjigantin maqedonas, Vardarin, i cili në sezonin vjeshtor ka përfunduar në vendin e dytë me 14 pikë më pak sesa "Shqiponjat" nga Tetova. Në këtë mënyrë, Shkëndija ka dhënë shenja të qarta se trofeu i kampionit të këtij edicioni nuk ka rrugë tjetër përveç asaj që çon në Tetovë, ku "Ballistët" e presin këtë trofe qe tetë vjet. Shkëndija deri më tani e ka fituar vetëm një titull të kampionit, atë të edicionit 2010-2011. Ndërsa viteve të fundit ka qenë konkurruese e vazhdueshme, por deri më tani e kishte thuajse të pamundur ta ndalë Vardarin, të cilin megjithatë nuk e linte rehat së ndjekuri. "Duhen uruar futbollistët për titullin e kampionit vjeshtor. Na mbetet edhe një tjetër pjesë e kampionatit gjatë të cilit Shkëndija duhet të vazhdojë me rezultate të ngjashme, natyrisht pas përgatitjeve që na presin pas përfundimit të këtij sezoni. Në këtë mënyrë besoj se do ta arrijmë qëllimin duke e fituar titullin e kampionit të Maqedonisë", ka deklaruar trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani. Edhe pse ekipi i tij stinorin pranveror do ta nisë me 14 pikë më shumë sesa Vardari, Osmani thotë se Shkëndija nuk do ta marrë si të kryer fatin e këtij edicioni, por do të vazhdojë me punë të mëdha. "Neve nuk na interesojnë ekipet rivale. Neve na interesojnë vetëm fitoret tona", ka potencuar Osmani, i cili ka thurur lëvdate për dy futbollistët kryesorë të ekipit, Ferhan Osmani dhe Besart Ibrahimi, të cilët po i "shkatërrojnë" portat e skuadrave tjera. Të dy ata deri më tani i kanë realizuar 30 gola: 17 Hasani dhe 13 Ibrahimi. Ata janë prijësit e Shkëndijës drejt Ligës së Kampionëve.

Fakte

Shkëndija po ecën sigurt drejt titullit të kampionit të Maqedonisë. Skuadra e madhe shqiptare i është afruar titullit të dytë në histori pasi sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e parë me 14 pikë më shumë sesa gjiganti maqedonas, Vardari.



Drenasi i "1

Moral Pozhegu

Derisa futbolli kosovar po përballet me probleme të mëdha në infrastrukturë, me ç'rast Përfaqësuesja e Kosovës i zhvilloi ndeshjet eliminatore të Botërorit në Shqipëri, stadiumi i Prishtinës vazhdon renovimin me hapa të breshkës e ai "Adem Jashari" po arnohet kohë pas kohe, Qeveria e Kosovës e ka marrë të hënën një vendim të rëndësishëm, në njërin prej projekteve më madhor të sportit kosovar pasluftës, por edhe të vet shtetit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Ramush Haradinaj, dje e ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Sportit rreth lokacionit të Stadiumit Nacional të futbollit.

Ministri Kujtim Gashi e ka paraqitur para Qeverisë së Kosovës lokacionin për ndërtimin e Stadiumit Nacional, duke kërkuar që të ndryshohet lokacioni nga Bërnica e Poshtme në Zonën Industriale të Drenasit, kërkesë kjo që është aprovuar nga Qeveria.

Sipas ministrit, ky lokacion është më i përshtatshëm, për shkak se gjendet në mes të Kosovës dhe nuk ka probleme me shpronësim të pronës, ashtu sikurse po ndodhte në Bërnicë, ndërkohë që është afër aeroporti dhe po ashtu edhe kryeqyteti.

Stadiumi Nacional do të ndërtohet në një hapësirë prej 25 hektarësh në Sankoc të Drenasit, 14 kilometra larg Prishtinës.

Vendimi për ndryshimin e lokacionit të Stadiumit Nacional kishte hapur debat të madh në Kosovë, pasi një pjesë e mirë e njerëzve të sportit ishin kundër zhvendosjes së tij në Drenas. Madje kishin filluar edhe shakatë, pasi kishte njerëz që thoshin se stadiumit duhet t'i vendoseshin rrotat për t'u zhvendosur herë në Prishtinë e herë në Drenas.

Fakte

Stadiumi Nacional do të ndërtohet në një hapësirë prej 25 hektarësh në Sankoc të Drenasit, 14 kilometra larg Prishtinës.



Sidoqoftë, ideja për ndërtimin e Stadiumit Nacional ishte përmendur së pari nga presidenti aktual i Kosovës, Hashim Thaçi, në vitin 2014 derisa Ministria e Sportit në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës e kishin lokalizuar në vitin 2016 vendin në Bërnicë të Poshtme.

Megjithëkëtë, vendimi u ndryshua sivjet pasi duket se politika, respektivisht politikanët, po mendojnë të fitojnë poenë politikë nga ndryshimet e lokacionit të këtij stadiumi.

Momentalisht, nuk dihet saktë se kur do të fillojë ndërtimi i tij, sa do të zgjasin punimet, kur do të jetë i gatshëm dhe se kush do ta ndërtojë?

Në Qeverinë e Kosovës thonë se punimet për ndërtimin e Stadiumit Nacional, respektivisht faza e parë, do të ndodhë në vitin 2018, por duke u bazuar nga e kaluara kur gjithmonë punët kanë nisur me vonesë dhe kanë shkuar zvarrë, ka vend për hamendje nëse vërtet ky

KËRKON TROFE TË RËNDËSISHËM

Futboll

Xherdan Shaqiri po kalon nëpër një formë të jashtëzakonshme me Stoke Cityn në Angli. Futbollisti kosovar vazhdon me shënimin e golave, por edhe me dhurimin e asistimeve. Dhe, paraqitjet e tij mbresëlënëse mund ta shpërblejnë pasi ai është futur në listë për t'u zgjedhur futbollisti më i mirë i muajit nëntor në Premierligë, së bashku me Salah, Hazard, De Bruyne, Richarlison e Young. Mirëpo, futbollisti kosovar, më shumë se të zgjidhet futbollisti më i mirë i muajit nëntor, do të preferonte trofe më të rëndësishëm pasi në të kaluarën e kishte fituar Bundesligën dhe Ligën e Kampionëve me Bayern Munichun. "Jam i lumtur që jam nominuar, por unë dua trofe më të çmueshëm. Nëse e fitoj do të ishte e mirë, do të thotë se jam duke bërë mirë. Do të shohim se kush do ta fitojë, por për mua nuk është gjëja më e rëndësishme. Unë ndihem mirë. Shpresoj që të vazhdoj me këtë ritëm për një kohë të gjatë", u shpreh përfaqësuesi zviceran. Ai thotë se gjithmonë luan për ekipin dhe synon të arrijë suksese kolektive.



Dardanisë"

Qeveria e Kosovës i ka mëshuar vulë lokacionit të ndërtimit të Stadiumit Nacional. Të hënën është hequr çdo dilemë, pasi u vendos përfundimisht që njëri prej projekteve më të rëndësishëm pasluftës të ndërtohet në Drenas, edhe pse fillimisht ishte vendosur që ai të bëhet në Prishtinë. Stadiumi Nacional do të ndërtohet në një hapësirë prej 25 hektarësh në Sankoc të Drenasit, 14 kilometra larg Prishtinës. Punimet pritet të nisin në vitin 2018



FOTO: DRITON BUBULAKU

Fakte

Punimet për ndërtimin e Stadiumit Nacional, respektivisht faza e parë, do të ndodhë në vitin 2018.

projekt gjigant do të nisë së ndërtuari vitin tjetër.

Gëzimi i Ramiz Lladrovcit

Vendimit për ndërtimin e Stadiumit Nacional i është gëzuar më së shumti kryetari i Drenasit Ramiz Lladrovci, i cili këtë gëzim e ka ndarë me deputetin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës Daut Haradinajn. "Faleminderit të gjithë kontribuuesve, në veçanti kryeministrit Haradinaj dhe kabinetit qeveritar, të cilët mirëpritën dhe miratuan propozimin e ministrit Kujtim Gashi që Stadiumi Nacional të ndërtohet në Drenas", ka shkruar fillimisht ai. "Këtë gëzim timin personal, por edhe të krejt Drenicës sot e ndava me Daut Haradinajn, në kujtim të të gjithë atyre që me jetën e veprën e vet i kontribuuan lirisë sonë, ndërsa sot angazhimit institucional për sundimin e ligjit dhe përparimin e Kosovës. Faleminderit dhe gëzuar qytetarë të Drenasit, Drenicës dhe krejt Kosovës, Stadiumi Nacional!", ka shtuar Lladrovci.

Pa diskutim Kosova ka nevojë më shumë se çdo vend tjetër për një stadium nacional, pasi Përfaqësuesja u desh të shtegtonte herë këndej e herë andej për të zhvilluar ndeshje zyrtare.

Qeveria hungareze ishte shprehur e gatshme ta ndërtojë Stadiumin Nacional me një kredi pa kamatë, por në "lojë" janë edhe turqit, të cilët i kanë fituar në të kaluarën tenderët për projektet më gjigante në Kosovë. Stadiumi Nacional pritet të emërohet "Dardania".

E treta e vërteta

Moral Pozhegu

Llapi e dominoi futbollin kosovar në pjesën e parë të kampionatit, të cilin e mbylli si kampion vjeshtor. Skuadra llapjane regjistroi 10 fitore, 4 barazime e 4 humbje dhe 34 pikët e grumbulluara ishin të mjaftueshme që ky ekip të dimërojë në krye të tabelës, i ndjekur nga Prishtina (32) e Drita (30). Trajneri Tahir Batatina po e shijon këtë moment magjik të skuadrës së tij. Ai thotë se ekipi Bardhekaltër e meritoi të jetë aty ku është falë organizimit të duhur dhe punës së madhe të bërë ndër vite. "Nuk ka qenë e lehtë pasi ka pasur shumë rivalitet në mes të pesë skuadrave të para të tabelës. Por ne e kemi komponuar si duhet ekipin, ishim të organizuar si duhet dhe me ardhjet e reja e kemi bërë një ekip solid. Avantazh yni ishte se e kishim bazën e ekipit nga sezoni i kaluar dhe do të vazhdojmë edhe më fuqishëm në pranverë për t'i arritur qëllimet tona", shprehet Batatina për "Zërin".

E do titullin e kampionit

Trajneri llapjan thotë se kjo është vetëm gjysma e rrugës dhe se frytet e punës së bërë do "të korren" në fund të sezonit kur Llapi synon ta fitojë titullin e kampionit. "Ne do të përforcohemi në të tria repartet, në mënyrë që në pranverë të jemi edhe më të fortë. Momentalisht e kemi fondin e mjaftueshëm, por konkurrenca i bën mirë ekipit. Nuk do të largohet asnjë lojtar. Do të mobilizohemi, në mënyrë që në pjesën e dytë të kampionit të jemi të fuqishëm dhe në fund ta fitojmë titullin e kampionit. Mendoj se e meritojmë këtë në bazë të asaj që kemi treguar deri më tash, por edhe në sezonet e kaluara", vazhdoi Batatina.

"Nuk ka qenë e lehtë pasi ka pasur shumë rivalitet në mes të pesë skuadrave të para të tabelës. Duam ta fitojmë titullin dhe të dalim në Evropë".

Sipas tij, rivali kryesor i Llapit për titull të kampionit do të jetë Prishtina, ndërsa nuk i sheh larg as Feronikelin e Dritën, për të cilën thotë se i nevojitet më shumë kohë të komponohet.

E do Evropën

Llapi nuk arriti të merrte pjesë në dy tentimet e para në garat evropiane. Në sezonin e parë pas pranimit UEFA nuk e lejoi asnjë skuadër kosovare të marrë pjesë në garat evropiane, ndërsa sezonin e kaluar e lëshoi mundësinë e artë pasi humbi në finale të Kupës së Kosovës nga Besa. Mirëpo, llapjanët nuk e kanë ndërmend ta lëshojnë edhe mundësinë e tretë. "Me vetë organizimin, infrastrukturën dhe lojën që e ka treguar Llapi ka demonstruar se ka skuadër solide dhe se e meriton pjesëmarrjen në garat evropiane. Kjo do të ishte e mirë për të gjithë futbollin kosovar. Ne duam të dalim në Evropë, kjo do të jetë e treta e vërteta për Llapin. Madje, mendoj se me një organizim të duhur mund t'i kalojmë disa runde dhe me këtë rast do të na shihte hairin krejt Kosova, pasi në sezonet pasuese mund të marrin pjesë në Evropë më shumë ekipe. Ekipet kosovare duhet ta ndihmojnë njëra-tjetrën në këtë drejtim", përfundoi Batatina.



Neymar nuk shkon te Reali



Sulmuesi i Barcelonës, Luis Suarez, thotë se ylli i Paris Saint-Germainit Neymar nuk do t'i bashkohet Real Madridit, për shkak të dashurisë që ka ndaj klubit katalonjas. Neymar u largua nga klubi spanjoll për 222 milionë euro në gusht në drejtim të Parisit. Por, që prej largimit të tij nga "Camp Nou" reprezentuesi brazilian ka qenë i lidhur me një rikthim të mundshëm në Spanjë, te rivali i Barcelonës, Real Madridi. Është raportuar se Neymar nuk është ambientuar siç duhet te klubi parisien dhe mund të largohet, ku njëri prej destinacioneve të mundshme është edhe klubi madrilen. Por, Suarez mendon se kjo situatë nuk do të ndodhë. "Jo, nuk do të ndodhë. Sinqerisht, nuk e shoh të mundshme", deklaroi Suarez. "E njoh Neymarin dhe admirimin që e ka pasur për Barcelonën dhe për bashkëlojtarët. Nuk besoj që ai do të shkojë të luajë për Real Madridin", shtoi reprezentuesi uruguaian.

Luhet për "jetë a vdekje"



Të martën dhe të mërkurën zhvillohen ndeshjet e fundit të fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve. Për shumë ekipe ndeshjet e xhiros së fundit të kompeticionit më prestigjioz evropian do të jenë për "jetë a vdekje". Sonte dhe nesër mësohen edhe ekipet e fundit që do ta kompletojnë të tetën e finales. Atletico Madridi do të shkojë vetëm për fitore në Londër kundër Chelseat dhe do të shpresojë për hap fals të Romës ndaj Qarabagut për ta gjetur kualifikimin. Ndërkohë në grupin B, Bayerni dhe PSG-ja do të luftojnë për kreun e grupit.

Sonte dhe nesër zhvillohen ndeshjet e fundit të fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve. Këtë javë do t'i mësojmë emrat e ekipeve të fundit që do ta kompletojnë të tetën e finales së këtij kompeticioni. Paris Saint-Germaini, Bayern Munichu, Chelsea, Barcelona, Manchester City, Besiktasi, Tottenhami dhe Real Madridi tashmë kanë siguruar kualifikimin në të tetën e finales, por kanë mbetur edhe tetë klube të tjera që ta kompletojnë 16-shen. Për disa ekipe kjo ndeshje do të jetë për "jetë a vdekje". Në grupin C, Atletico Madridi do të udhëtojë drejt Londrës me një mision të vetëm – fitoren. Klubit spanjoll i nevojitet një fitore kundër Chelseat, skuadër e cila ka siguruar kalimin në fazën tjetër dhe do të shpresojë për një hap fals të Romës kundër Qarabagut të reprezentuesit shqiptar, Ansi Agolli, për të siguruar kualifikimin në fazën tjetër të Ligës së Kampionëve. Në Grupin A, Manchester Unitedi thuajse ka siguruar kualifikimin për shkak të diferencës prej tri pikësh me vendin e dytë dhe të tretë, por lufta kryesore do të zhvillohet për vendin e dytë. Baseli dhe CSKA e Moskës, që gjendet në pozitat dy dhe tre, kanë pikë të barabarta dhe do të kërkojnë fitore në takimet e tyre përkatëse. Shanset më të mëdha për kualifikim i ka Baseli që i shkon Benficas, klubi i cili numëron zero pikë, ndërsa klubi rus do të udhëtojë drejt

LIGA E KAMPIONËVE

E martë	
Grupi A	
20:45	Benfica – Basel
20:45	Man United – CSKA
Grupi B	
20:45	B. Munich – PSG
20:45	Celtic – Anderlecht
Grupi C	
20:45	Chelsea – A. Madrid
20:45	Roma – Qarabag
Grupi D	
20:45	Barcelona – Sporting
20:45	Olympiacos – Juventus

LIGA E KAMPIONËVE

E mërkurë	
Grupi E	
20:45	Liverpool – Spartak
20:45	Maribor – Sevilla
Grupi F	
20:45	Feyenoord – Napoli
20:45	Shakhtar – Man City
Grupi G	
20:45	Porto – Monaco
20:45	Leipzig – Besiktas
Grupi H	
20:45	R. Madrid – B. Dortmund
20:45	Tottenham – APOEL

1

ANCELOTTI: ITALIA MË KA KONTAKTUAR

Trajneri Carlo Ancelotti konfirmoi se ai është kontaktuar nga Federata Italiane e Futbollit për pozitën e përzgjedhësit të përfaqësueses. Ish-trajneri i Bayern Munichut ishte favoriti kryesor për të marrë drejtimin e përfaqësueses italiane pas shkarkimit të Giampiero Venturas. "Po, Federata më ka kontaktuar, kam folur me ta. U thashë atyre atë që po ua them juve, jam i nderuar se kaq shumë njerëz duan që unë të jem trajneri i kombëtares", deklaroi Ancelotti.
"Sidoqoftë, kjo do të ishte si të kem një punë krejtësisht tjetër. Të jesh përzgjedhës është ndryshe nga të qenit trajner i një klubi sepse unë ende shijoj të trajnoj dhe të punoj çdo ditë. Futbolli italian gjithashtu i ka disa probleme që duhet të zgjidhen", shtoi ndër të tjera strategu italian.

2

KLUBET ANGLEZE PAS N'ZONZIT


Arsenali dhe Evertoni janë vetëm dy prej disa klubeve që janë duke shprehur interesim për mesfushorin e Svillas, Steven N'Zonzi. Reprezentuesi francez është rikthyer përsëri në listën e objektivave të klubit londinez dhe pas një përplasjeje me trajnerin e Sevillas, Eduardo Berizzo, në barazimin 3:3 kundër Liverpoolit në Ligën e Kampionëve, mesfushori mund të joshet nga ideja për t'u kthyer në Premierligë. N'Zonzi ka një klauzolë lirimi prej 40 milionë eurosh dhe Arsenali nuk do ta kishte problem që ta paguante këtë shifër. Ndërkohë edhe trajneri i ri i Evertonit, Sam Allardyve, është duke shprehur interesim për ish-mesfushorin e Stoke Cityt. Allardyce kërkon që ta përforcojë skuadrën gjatë afatit kalimtar të janarit.



Wenger nuk heq dorë nga titulli



Trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, insiston se ekipi i tij ende është në garë për titullin e Ligës angleze. Francezi thotë se për dallim prej homologut të tij te Tottenhami, Mauricio Pochettino, ai ende beson që ekipi i tij mund ta fitojë titullin. Pochettino kishte deklaruar pas barazimit 1:1 me Watfordin të shtunën se ekipi i tij nuk ka më shanse për titull. "Unë nuk jam Pochettino. Unë jam Arsene Wenger", deklaroi strategu francez. "Jam këtu për të luftuar sa të mundem, përderisa matematikisht është e mundshme, duhet të luftoni, ju nuk mund të jepni ndonjë mesazh tjetër", shtoi Wenger. Arsenali momentalisht gjendet në vendin e pestë në tabelë me 28 pikë, 15 sosh më pak sesa vendi i parë, që mbahet nga Manchester City.



Paris Saint-Germaini, Bayern Munichu, Chelsea, Barcelona, Manchester City, Besiktasi, Tottenhami dhe Real Madridi tashmë kanë siguruar kualifikimin në fazën tjetër.

Anglisë për t'u ballafaquar me Manchester Unitedin. Bayern Munichu dhe Paris Santi-Germaini tashëm kanë siguruar kualifikimin në grupin B, por ndeshja mes tyre do të na tregojë se kush do të përfundojë në vendin e parë. Gjigandi bavarez pret parisienët në shtëpi dhe do të kërkojë hakmarrjen pas asaj humbjeje prej 3:0 në Francë. Ndërkohë, në Skoci Celticu do ta presë në shtëpi Anderlechtin. Këto skuadra pritet të luftojnë për vendin e tretë, që dërgon në Ligën e Evropës. "Nxehtë" pritet të jetë edhe në grupin D. Barcelona tashmë ka siguruar kualifikimin, por në garë për një vend në të tetën e finales janë Juventusi dhe Sportingu. Klubin italian dhe atë portugez i ndan vetëm një pikë. Juventusi udhëton për në Greqi për të luajtur me Olympiacosin, kurse Sportingu i shkon Barcelonës.

3

NUK JEMI BARÇA APO REALI

Trajneri i Tottenhamit, Mauricio Pochettino, u është përgjigjur kritikëve të ekipi të tij pas dështimit për të fituar në katër ndeshjet e fundit. Pochettino thotë se ekipi i tij nuk është në një nivel me Barcelonën apo me Real Madridin. "Nuk e di se çfarë thonë njerëzit, por sigurisht që kur nuk fitoni dhe menaxhoni apo luani për Tottenhamin gjithmonë do të ketë kritika", deklaroi Pochettino. "Por, sigurisht unë i pranoj këto, provoj që të mësoj pas çdo ndeshje, por mendoj që në dy apo tri edicionet e fundit Tottenhami ka qenë shumë garues", shtoi strategu argjentinas. "Po, sigurisht që duam t'i shmangim momentet e këqija, por ne ende nuk jemi në nivelin e Barcelonës, Real Madridit që ndoshta mund të vazhdojnë me fitore për periudha të gjata", u shpreh ai.

1

Fitojnë Golden State dhe Oklahoma

Stpehen Curry shkëlqeu në këtë fitore të "Luftëtarëve" me 30 pikë, kurse Kevin Durant realizoi 24 sosh. Përveç tyre, në këtë ndeshje u dallua edhe Draymond Green me 7 kërcime dhe 9 asistime

Golden State ka shënuar fitore në udhëtim te Miami Heat me rezultatin 95:123. Stpehen Curry shkëlqeu në këtë fitore të "Luftëtarëve" me 30 pikë, kurse Kevin Durant realizoi 24 sosh. Përveç tyre, në këtë ndeshje u dallua edhe Draymond Green me 7 kërcime dhe 9 asistime. Ndërkohë, për Miamin Goran Dragic shënoi 20 pikë, kurse Kelly Olynyk realizoi 14 pikë, 5 asistime dhe bëri 7 kërcime. Oklahoma City Thunder ka korrur fitore në shtëpi kundër San Antonio Spurs me rezultatin 90:87. Russell Westbrook ishte më meritori për këtë fitore të nikoqirëve me 22 pikë të shënuara dhe 10 asistime të realizuara. Ndërsa për ekipin mysafir Dejounte Murray shënoi 17 pikë, bëri 11 kërcime dhe realizoi 5 asistime. Fitores gjithashtu i është gëzuar edhe Houston Rosckets në udhëtim te LA Lakers me rezultatin 95:118. James Harden ishe më i dalluari te Houston me 36 pikë të shënuara dhe 9 asistime.



Rezultatet: Miami – Golden State 95:123, Minnesota – LA Clippers 112:106, Oklahoma – San Antonio 90:87, LA Lakers - Houston 95:118.

2

Silva, më i miri i Cityt

Jamie Carragher thotë se mesfushori David Silva është lojtari më i mirë në historinë e Manchester Cityt. Klubi nga "Etihad" triumfoi me rezultat të ngushtë 2:1 ndaj West Hamit të dielën falë një goli të vonshëm të Silvas

Ish-mbrojtësi i Liverpoolit, Jamie Carragher, thotë se mesfushori David Silva është lojtari më i mirë në historinë e Manchester Cityt. Klubi nga "Etihad" triumfoi me rezultat të ngushtë 2:1 ndaj West Hamit të dielën falë një goli të vonshëm të Silvas. Kjo fitore e ndihmoi ekipin e Pep Guardiolas që të vazhdojë serinë prej 13 fitoreve radhazi në ligën angleze. "Silva është lojtari më i mirë në historinë e Manchester Cityt", tha Carragher. Silva i ishte bashkuar klubit anglez nga Valencia në vitin 2010 për 26 milionë funte. Gjatë këtyre viteve ai ka fituar dy herë ligën angleze, një "FA Cup" dhe dy Kupa të Ligës. "Zhgënjimi i vetëm



është mosha e tij, sa gjatë do të luajë? Ai radhitet krah Thierry Henrys, Dennis Bergkampit dhe Eric Cantonas, ai është njëri prej më të mirëve që kemi pasur në Premierligë", u shpreh ai.

3

Kemi ende rrugë për të bërë

Piero Ausilio thotë se klubi italian ende ka rrugë të gjatë për të bërë dhe se ekipi duhet të qëndrojë i përqendruar.

Drejtori sportiv i Interit, Piero Ausilio, thotë se klubi italian ende ka rrugë të gjatë për të bërë dhe se ekipi duhet të qëndrojë i përqendruar. Inter u ngrit në vendin e parë të ligës italiane pas fitores 5:0 kundër Chievos të dielën. Klubi ziekaltër shfrytëzoi humbjen e Napolit kundër Juventusit për të marrë vendin e parë në kampionat. "Është mirë kur je në krye, por preferoj që të jem realist. Ne duhet të qëndrojmë të përqendruar, rruga është ende e gjatë", deklaroi Ausilio. "Të gjithë po na ndjekin dhe gjërat mund të ndryshojnë për një kohë të shkurtër, por Interi dëshiron që të qëndrojë lart", shtoi ai. Ausilio gjithashtu foli edhe për afatin kalimtar të janarit dhe tha se nuk pritet që të ketë transferime nga Interi.



02

Adrianne Palicki



Karrierën e ka filluar si aktore dhe vazhdon të jetë e tillë edhe tani, ndërsa njihet për rolet në seritë "The Agents of S.H.I.E.L.D" dhe "Friday Night Lights", por falë bukurisë dhe pamjes seksi Adrianna Palicki është shndërruar edhe në modele tejet të njohur.



Inspirohet nga gjyshja e saj

Adriana Lima konsiderohet si njëra nga femrat më të bukura dhe më seksi në botë. Mirëpo bukuroshja braziliane ka deklaruar se gjyshja e saj Julia, 95-vjeçare, është inspirimi më i madh në jetën e saj. Zeshkania atraktive ka rrëqethur të gjithë kur në profilin e saj në "Instagram" ka postuar fotografinë e gjyshes së saj Julia. "A dëshironi të dini se kush është inspirimi im? Kjo është gjyshja ime Julia. Është 95 vjeçe. Nuk ka nevojë për kurrfarë përshkrimi tjetër", ka deklaruar Adriana. Edhe në të kaluarën bukuroshja ka deklaruar se nga anëtaret femra të familjes së saj ajo ka mësuar shumë. "Mamaja dhe gjyshja më kanë mësuar të jem një femër e fortë dhe me plot vetëbesim. Të njëjtën gjë mundohem t'ua mësoj edhe vajzave të mia, Valendina dhe Sienna. Dua që me vajzat e mia të ndajë atë që më kanë mësuar mua nëna dhe gjyshja

"A dëshironi të dini se kush është inspirimi im? Kjo është gjyshja ime Julia. Është 95 vjeçe. Nuk ka nevojë për kurrfarë përshkrimi tjetër", ka deklaruar Adriana

ime: Se bukuria vjen nga brenda dhe se virtytet dhe mangësitë tona na bëjnë të veçanta", ka deklaruar bukuroshja. Edhe pse në karriera e saj po lulëzon gjithnjë e më shumë, kur vjen puna tek dashuria, ajo vërtet është një vajzë e pafat. Që prej ndarjes nga bashkëshorti Marko Jaric Adriana nuk ka mundur të gjejë lumturi në planin e dashurisë dhe lidhjet e saj nuk mund të zgjasin më shumë se disa muaj e në disa raste edhe javë. Sido që të jetë, ajo mbetet e përkushtuar në rritjen e vajzave.

Susanna Canzian, bukuroshja që çmendi edhe Silvio Berlusconin

E njohur për pozimet e saj superseksi, por edhe kalendarët tejet të nxehtë dhe provokues, Susanna Canzian pa dyshim se është njëra nga modelet dhe aktoret më të bukura dhe më seksi italiane. Me një guxim të jashtëzakonshëm, kjo bukuroshe nuk ngurron që të pozojë tërësisht e zhveshur para fotoaparatit, ndërsa falë këtyre fotove ajo ka bërë miliona ndjekës në rrjetet sociale dhe ka bërë që shumë meshkuj të famshëm të çmenden pas saj. Por fama e saj nuk do të ishte e plotë po të mos ishin edhe skandalet e shumta seksuale, por edhe arrestimet nën dyshimin e ushtrimit të prostitucionit me njerëz të famshëm dhe të pasur. Por pa dyshim se skandali më i madh i saj ishte afera e saj e dashurisë me ish-kryeministrin dhe ish-presidentin italian, miliarderin Silvio Berlusconi. Në të vërtetë bashkëshortja e Silvios, Francesca Pascaole, kishte kuptuar për aferën e burrit të saj me bukuroshen dhe menjëherë kishte filluar procedurat e divorcit. Pas përhapjes së lajmit në mediumet botërore Susanna i kishte kërkuar Francescas të pajohen, duke i kërkuar të harrojnë skandalin dhe të vazhdojnë tutje me jetën e tyre, duke insistuar se ishte vetëm një takim me Silvion dhe nuk ka pasur ndonjë pretendim serioz ndaj tij. "Eja të bëhemi shoqe", i kishte shkruar ajo Francescas, por kjo e fundit e kishte injoruar. Por mediet kanë shkruar se Silvio çmendej pas bukuroshes dhe e kishte paguar majmë për shërbime seksuale, por këtë e kishte bërë vetëm një herë dhe më nuk kishte pranuar ofertat e tij. Në anën tjetër, ajo ishte në mesin e dhjetëra modeleve dhe këngëtareve të arrestuara në Monako, nën akuzën se ishin shoqëruese për favore seksuale të njerëzve të pasur dhe të famshëm, por ajo ishte liruar pas disa ditëve, pasi nuk kishte pasur dëshmi të mjaftueshme se kishte kryer shërbime seksuale me pagesë. Por kjo nuk e ka tronditur aspak bukuroshen dhe ajo ka vazhduar të ndërtojë me sukses të madh karrierën e saj, duke u paraqitur në kalendarë të nxehtë, fushata mode, role televizive dhe në filma.

1

ANKOHEN SE MË MESHKUJT S'E DUAN

Dikur ishte njëra nga femrat më të dëshiruara në botën e shoubiznesit, por tani modelja dhe aktorja Denise Van Outen thotë se meshkujt e kanë humbur interesimin për të, pasi tashmë ka mbushur 41 vjet. Edhe pse insiston se me të gjitha forcat mundohet të mbajë trupin e saj vital si dhe pamjen e bukur, ajo ankohet se meshkujt më nuk e ngacmojnë siç e ngacmonin dikur. "Siç e dini, tashmë kam mbushur 41 vjet dhe kjo më ka shkaktuar shumë probleme, sidomos në fushën e dashurisë, pasi meshkujt më nuk më duan. Thjesht ata e kanë humbur interesimin për mua. Si duket janë të kota përpjekjet e mia të vazhdueshme që të kem një trup vital dhe një pamje të bukur, pasi kjo nuk po josh aspak meshkujt", është ankuar Denise. Biondina seksi ka qenë në lidhje me disa nga meshkujt më të njohur në shoubiznes, por romancat e saj asnjëherë nuk kanë përfunduar në lidhje serioze.

2



E pranon se nuk i do fansat

Aktorja e Hollivudit, Jennifer Lawrence, ka zbuluar se nuk e pëlqen të fotografohet me fansat dhe ka folur se si sillet kur ata i afrohen. Bukuroshja njihet për sjelljet e saj qesharake, por nuk është aspak e lumtur kur adhuruesit mundohen të njoftohen me të. Ajo e ka pranuar se nuk i pëlqen fansat, posaçërisht jo në afërsi të saj. Ajo nuk ngurron t'u thotë atyre se ka ditën e lirë dhe duhet ta lënë të qetë. "Posa një fans të më drejtohet bëhem shumë e pasjellshme. Kjo është e vetmja mënyrë që të mbrohem nga ata, që të kem pakëz privatësi. Nëse dikush më kërkon të fotografohemi apo të bëjmë selfi unë i drejtohem ashpër: 'nuk mundet' dhe e shikoj vrazhdët", ka zbuluar aktorja, e cila momentalisht është ndër aktoret më të popullarizuara në Hollivud.



AFERA

Pa dyshim se skandali më i madh i saj ishte afera e saj e dashurisë me ish-kryeministrin dhe ish-presidentin italian, miliarderin Silvio Berlusconi

5 Nga Holly Willoughby e deri te Katie Price, secila është munduar të duket madhështore në ngjarjen 'ITV Gala' dhe Jess Shears "Love Island's" nuk ishte një përjashtim. Përderisa të tjerat kishin vendosur për kreacione të emrave të mëdhenj të modës, Jess kishte zgjedhur kreacion modest. Në të vërtetë ajo ishte përcaktuar për një dizajn të shtëpisë së modës "Asos", që është një fustan me një krah dhe me prerje të thellë tek këmbët. Edhe pse ky fustan kushton vetëm 66 euro, ai duket madhështor dhe të gjithë i kishin sytë tek bukuroshja derisa ajo ka defiluar në qilimin e kuq të kësaj ngjarjeje.







I shpëtoi abuzimit seksual

Ky producent, të cilin ajo nuk ka dashur ta zbuloj se kush ishte, e kishte ftuar Natalie që së bashku me të dhe kolegët nga kompania, të udhëtojnë me një avion privat

Pasi shumë kolege të saj kanë folur rreth abuzimeve seksuale që u kanë ndodhur nga njerëzit e fuqishëm të Hollivudit, përvojën e saj e ka ndarë edhe ylli i filmit Natalie Portman. Aktorja e bukur ka rrëfyer se kishte arritur ta shmangë një ofertë amorale nga një producent i njohur. Ky producent, të cilin ajo nuk ka dashur ta zbuloj se kush ishte, e kishte ftuar Natalie që së bashku me të dhe kolegët nga kompania, të udhëtojnë me një avion privat. Në këtë ajo nuk kishte parë asgjë të keqe dhe e kishte pranuar ofertën. "Kur kam arritur, e kam kuptuar se atje ishim vetëm unë dhe ai si dhe një krevat martesor", ka zbuluar fituesja e çmimit Oskar. Për fat të mirë, producenti e kishte pranuar 'Jo"-n si përgjigje. "Nuk më ka sulmuar. Kur i kam thënë se nuk ndjehesha mirë, ai e ka respektuar këtë", ka rrëfyer Portman. Aktorja ka shtuar se ngjarjet e fundit në industrinë filmike, e kanë tronditur rëndë. "Kur e kam lexuar për herë të parë, kam menduar në veti: "Jam vërtetë e lumtur që nuk e kam përjetuar një gjë të tillë", kishte deklaruar ajo në atë kohë. Bukuroshja që nga viti 2012 është në martesë të lumtur me vallatarin dhe koreografin Benjamin Millepied, me të cilin është njoftuar gjatë xhirimit të filmit "Black Swan. Çifti ka dy fëmijë së bashku, djalin Aleph 6 dhe vajzën nëntëmuajsh, Amalia.

3

KA HEQUR DORË NGA E BIJA!

Po ta pyesni aktorin Tom Cruise se kur do të takoheni me vajzën Suri, ai do t'ju përgjigjej se nuk është koha për diçka të tillë. Suri Cruise më nuk është një vajzë e vogël dhe gjithnjë e më shumë është e vetëdijshme për situatën në të cilën po rritet dhe e cila nuk është e përkryer. Sipas shkrimit të mediave amerikane, Tom nuk e ka parë vajzën e tij tashmë katër vite, kjo për shkak të xhirimit të filmave, por edhe për fajin e kishës së skajëntologjisë, e cila ia ndalon atij që të komunikoj me anëtarët e familjes që nuk janë pjesë e kësaj kishe. Vajza e tij nga martesa me aktoren Katie Holmes, kohë më parë ka mbushur 11 vite dhe babai i saj po i mungon gjithnjë e më shumë. Nga ana tjetër, Katie mundohet t'i siguroj Surit fëmijëri pa brenga, ndërsa për këtë e ka mbështetjen edhe të dashurit të saj të ri, Jamie Foxx, i cili gjithashtu ka dy fëmijë nga martesa e mëparshme.



4

E çmendur pas ushtrimeve

Rosie Huntington-Whiteley "ushtron si e çmendur" për ta mbajtur trupin e saj në superformë. Biondja atraktive, e cila deri më tani ka defiluar për emra të mëdhenj si "Victoria's Secret", "Vogue", si dhe ka reklamuar koleksionin e vet të veshjeve intime nga kompania "Marks and Spencer", e ka pranuar se mbajtja e trupit vital nuk është aspak e lehtë dhe kjo përfshin një regjim të ashpër të ushtrimeve dhe udhëtime të vazhdueshme në palestër. "Prindërit e mi gjithmonë kanë inkurajuar sportin dhe ushtrimet. Unë ushtroj si e çmendur, në mënyrë që të mund të kënaqem duke ngrënë ushqime të preferuara", ka thënë ajo për mediet e huaja. Modelja e lindur në Britani, por e cila tani jeton në Los Anxhelos, insiston se nuk e privon veten nga asgjë.

KIDZ

E pyesin Trimin a është më mirë të jesh tullac apo budalla?
- Budalla, tha ai, më pak shihet.



Shprehia e të kursyerit mësohet nga prindërit

Prindërit duhet të jenë ata që duhet t'i mësojnë fëmijët e tyre se si të dinë të kursejnë. Së pari, ju duhet t'ua bëni të qartë se sa kanë të drejtë të shpenzojnë ata nga kompensimet që u japim. Në moshën 6-8 vjeçe fëmija duhet të jetë përgjegjës vetëm për shpenzime të vogla, sikurse për blerjen e librave komikë apo harqe flokësh. Gjithashtu mund t'ju përcaktojmë që nuk janë të lejuar që të shpenzojnë para në bonbone apo çamçakëzë. Brenda këtyre parametrave, pastaj u mbetet atyre që të vendosin se si do të menaxhojnë me të hollat e tyre. Por ua bëni me dije që në qoftë se i shpenzojnë të gjitha paratë e kursyera në vetëm një gjësend nuk ka më të holla deri në afatin tjetër kur ua shpërndajmë të hollat. Qëllimi është që të ndihmojmë fëmijët tanë që të mësojnë se si të menaxhojnë një sasi të caktuar të parave. Një javë ata mund të vendosin se fotot që ngjiten në fletore janë më të rëndësishme se harqet për flokë, një javë tjetër mund të kuptojnë se në qoftë se nuk i harxhojnë të gjitha të hollat në një gjësend ata mund të ruajnë apo t'u mbetet kusur për diçka që ata me të vërtetë e dëshirojnë. Kur vendosni në shumën që do t'ua jepni fëmijëve tuaj merreni në konsideratë koston e shpenzimeve javore të tyre. Pyesni se çfarë bëjnë familjet e tjera? Paratë e xhepit brenda një jave për fëmijët 6 deri në 8-vjeçar duhet të jetë 5 euro në javë dhe jo më shumë. Nuk rekomandohet dhënia e parave të xhepit për fëmijët parashkollorë, pasi ata në përgjithësi nuk e kuptojnë idenë abstrakte të të hollave. Nëse i aplikoni këto metoda, atëherë fëmijët tuaj kur të rriten do të bëhen shumë të përgjegjshëm me paranë e tyre.

Kur vendosni në shumën që do t'ua jepni fëmijëve tuaj merreni në konsideratë koston e shpenzimeve javore të tyre. Pyesni se çfarë bëjnë familjet e tjera? Paratë e xhepit brenda një jave për fëmijët 6 deri në 8-vjeçar duhet të jetë 5 euro në javë dhe jo më shumë.

FJALË E URTË

Suksesi vjen tek ata që janë shumë të zënë duke e kërkuar atë.

POEZI

Fjollë për fjollë

Tash ëndërroj jetën
Mes stinëve
Cilat janë notat
Nëpër kohë
bashkë me to të ecet
dhe cila është
Gjuha e tyre e vjetër
Vjeshta gjithmonë
e ka kopshtin
më të madh
me vreshta
Në kokrra rrushi
lehtë fshihet vesa
Kallëzimi për dimrin
Gjen një tjetër shteg
Me sajën time
Fjollë për fjollë do e
Ndjek…

Nezir Sefaj

Fëmijë të dashur, ju mund të dërgoni punimet tuaja, të cilat mund të jenë në formë të poezisë, tregimit, vjershës, apo të ngjashme

@ kidz@zeri.info

?

Banorët e Emirateve të Bashkuara nuk kanë obligim të paguajnë kurrfarë tatimi.

Majmunia dhe qenushi


Majmunia jetonte në shtëpinë e një burri bashkë me një qen,që ishte aq shumë i vogël sa është më mirë të themi qenushi. Një mbrëmje majmunia dhe qenushi ishin vetëm në shtëpi nën dritën e qiriut. I zoti kishte dale dhe majmunia, që siç e dini imiton njeriun sa here që ka mundësi, donte të bënte si ai. Mori qiriun dhe u largua. - Jo!- bërtiti qenushi. – Të lutem, mos më lër këtu vetëm në mes të errësirës! - Do qëndroj pak jashtë sa të marr një çikë ajër, - iu përgjigj majmunia. – Pastaj, pse thua në mes të errësirës, nuk e sheh që pas teje ka një qiri të ndezur? Në të vërtetë në dhomë ishte një pasqyrë ku reflektohej qiriu i ndezur. -E shikon apo jo? – e pyeti majmunia. -Po, e shoh…, - iu përgjigj qenushi. Nuk e kishte mbaruar mire fjalën dhe u gjind i vetëm ne errësirë. Kështu i ndodhi atij që nuk di të dallojë pamjen mashtruese nga e vërteta.



Fenomeni i rrallë, ylberi zgjat për plot 9 orë



Ylberi mund të ofrojë pamje mahnitëse, por për shumicën e njerëzve spektakli zgjat shumë pak. Por, ky nuk ka qenë rasti i disa profesorëve dhe studentëve në Universitetin kinez të Kulturës në malet e Taipeit, të cilët mundën të shijonin një ylber që zgjati plot 9 orë. Një profesor nga Departamenti i Shkencave Atmosferike, Chou Kunhsuan, e ka quajtur dukurinë të mrekullueshme, një dhuratë nga qielli. Ai bashkë me kolegë e studentë të Departamentit u përpoqën të dokumentonin ngjarjen e rrallë. Ylberet zgjasin zakonisht më pak se një orë. Vëzhgimet e tyre, fotot dhe regjistrimet video tregojnë se fenomeni zgjati nga ora 6:57 deri në 15:55, i thënë ndryshe 8 orë e 58 minuta.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në

Shitjen 38

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: **e mërkurë 06 dhjetor 2017**, prej orës **10:00 - 12:00**,

në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, Prishtinë.

*** Shënim: Njësitë në vijim janë tërhequr nga Shitja e aseteve 38:**
Njësia nr. 06: Pasuria Bujqësore Toka në Sojevë (Lot B)
Njësia nr. 75: Ratar Tokë Bujqësore Prishtinë III
Njësia nr. 80: Ratar Tokë Bujqësore Matiçan III

Si duhet të përgatitet oferta:

OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një **pliko (zarf)** të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**
Brenda këtij zarfi (ZARFI 3), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: ZARFI 1 dhe ZARFI 2

OFERTA PËR SHITJEN E ASETEVE NR.....
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

ZARFI 3

ZARFI 1


INFORMATA SHTESË PËR OFERTËN
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

ZARFI 2

ÇMIMI I OFERTËS
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit
"Informata shtesë për ofertën"

1. Dokumentet e cekura në **pikën 8.6. ii** të Rregullave të Tenderit.
2. Origjinalin e formularit për dorëzimin e ofertës - **"SHTOJA C"**, e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesi.
3. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e AKP-së.
4. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së.



* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 38 të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**
Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173
Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevci Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: + 381 (0) 38 500 400 lok. 2004, 1090,1105, ose 1152 / fax: + 381 (0) 38 248 076
e-mail: shitja@pak-ks.org ose **sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 6 të Rregullores Nr.01/2017 për Marrëdhënie Pune me datën 05.12. 2017, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendeve të lira të punës

I. Pozita: Auditor
Kodi: A/ZKA/23-12/17
Grada: Përcaktohet me akt të veçantë
Numri i pozitave: Dy (2)
Kohëzgjatja: Me kohë të pacaktuar
Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

1. Ne mënyrë efektive koordinon punën e auditimit me Udhëheqësin e ekipit dhe ofron mbështetje në ekip si ekspert i auditimit;
2. Përfitimi i njohurive të plota rreth institucioneve të audituara dhe kuptueshmëri të plotë të çështjeve, prioriteteve dhe rreziqet që i ballafaqojnë ato (pako për njohjen e punës);
3. Ndihmon UEA-në në planifikim të auditimit, duke përfshirë programet dhe metodat auditimit;
4. Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga UE dhe Udhëheqësi i Departamentit;
5. Raportimi i vazhdueshëm te mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
6. Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës për çdo fazë të auditimit dhe dorezimi i tyre tek UEA;
7. Ofron përkrahje profesionale duke kryer procedura analitike të të dhënave financiare dhe jo financiare;
8. Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike dhe gjykimet për të arritur në konkluzione të qëndrueshme në bazë të dëshmive të mbledhura;
9. Përgatitja e LP (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar;
10. Kryen detyra tjera të ngarkuara nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë fakulteti;
- Së paku 7 vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet apo financa;
- Certifikim në njërën nga skemat e certifikimit për kontabilist, auditor apo auditor i brendshëm.
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale, aftësi të mira komunikimi verbal dhe në të shkruar si dhe njohuri të mirë rreth gjuhës angleze.

Informata të përgjithshme për kandidatë:
Përcaktimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e konkurrimit:
Dokumentet e nevojshme për aplikim: Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi personale (CV), nga një letër motivuese, si dhe dëshmitë/ dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollore dhe për përvojën e punës të kërkuar sipas konkursit.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit: http://www.zka-rks.org/

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: rekrutimi@oagks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në zyrën e Divizionit për Burime Njerëzore të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është dita e mërkurë, 20 dhjetor 2017, ora 16.00.

Shënim:
Kërkesat e dërguara pas afatit të përcaktuar me konkurs nuk do të shqyrtohen. Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit eventual të madh të kërkesave të pranuara, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

U skladu sa članom 15 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, članom 5 i 6 Pravilnika Br. 01/2017 o Radnom Odnosu, Nacionalna Kancelarija Revizije dana: 05.12.2017-god, objavljuje:

KONKURS
za popunjavanje slobodnih radnih mesta

I. Radno Mesto: Revizor
Referenca: A/ZKA/23-12/17
Nivo: Određuje se posebnim aktom
Broj radnih mesta: Dva (2)
Trajanje: Na neodređeno vreme
Mesto: Priština

Dužnosti i odgovornosti:
1. Efektivno koordiniše revizorski rad sa Vođom tima i pruža podršku timu kao stručnjak revizije;
2. Dobijanje potpunog znanja o revidiranim institucijama kao i potpuno shvatanje pitanja, prioriteta i rizika sa kojima se one suočavaju (paket za poznavanje rada);
3. Pomaže VRT-a u planiranju revizije, uključujući programe i metode revizije;
4. Odgovorno obavljanje zadataka datih od strane VT i Rukovodioca Departmana;
5. Stalno izveštavanje menadžmenta u vezi sa napretkom koji je postignut u reviziji;
6. Izrada i indeksiranje radnih papira za svaku fazu revizije i njihovo dostavljanje kod VRT;
7. Pruža profesionalnu podršku preko obavljanja analitičkih procedura finansijskih i ne finansijskih podataka;
8. Korišćenje tačnih analitičkih procedura i mišljenja za donošenje održivih zaključaka zasnovanih na prikupljenim dokazima;
9. Priprema RP (rezimiranih memoranduma) u vezi sa revizijom revidirane komponente ili oblasti koja mu/joj je dodeljena;
10. Izvršava i druge zadatke koji se zahtevaju od nadređenog

Minimalne kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:
- Fakultetska diploma;
- Najmanje 7 godina stručnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu ili finansijama;
- Sertifikacija u jednoj od šema sertifikacije za računovođu, revizora ili unutrašnjeg revizora;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine, dobre veštine u verbalnoj i pismenoj komunikaciji i dobro poznavanje engleskog jezika.

Opšte informacije za kandidate:
Utvrđivanje plate za objavljena radno mesta se obavlja u skladu sa unutrašnjim aktima Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura Konkurisanja:
Dokumenta koja su potrebna za apliciranje: Zainteresovani kandidati treba da podnesu relevantnu aplikaciju, propraćenu sa ličnom biografijom (CV), motivacionim pismom kao i relevantnu dokumentaciju o zatraženim kvalifikacijama i radnom iskustvu koje se zahtevaju konkursom.

Obrazac aplikacije se u fizičkoj verziji može dobiti kod recepcije Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova ali se istovremeno može skinuti sa internet stranice Nacionalne Kancelarije Revizije: http://www.zka-rks.org/

Aplikacije sa svim dokumentima se mogu poslati elektronskom poštom na adresi rekrutimi@oagks.org, preko pošte ili se mogu podneti u fizičkoj verziji pri Departmanu Ljudskih Resursa Nacionalne Kancelarije Revizije.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objavljivanja, a krajnji rok za podnošenje aplikacija je sreda, 20. decembar 2017 godine, u 16:00 časova

Napomena:
Aplikacije pristigle nakon roka koji je predviđen konkursom neće biti razmotrene. Sve ne kompletirane aplikacije će biti odbijene. Zbog eventualnog velikog broja primljenih zahteva, kontaktiraće se samo kandidati koji se uvrste u užem izboru.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

Në bazë të nenit 4 të rregullores për procedure e rekrutimit të praktikantëve në **Gjykatën Themelore në Gjilan –degët e saj** , për praktikant vullnetarë (pa Pagesë), për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti

K O N K U R S

Nr.4/2017

Për praktikantë vullnetarë:

1. **Gjykata Themelore Gjilan---------- 35 praktikantë**
2. **Dega në Kamenicë_____ 10 praktikantë**
3. **Dega në Viti_____ 10 praktikantë**
4. **Dega Novobërdë-_____ 3 praktikantë**

Përshkrimi i detyrave të punës

Titulli i pozitës: **Praktikantë**

Nëpunësi mbikëqyrës: Administratori i Gjykatës dhe Nd. Administratorët

Detyra e praktikantit: Ndihmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore:

Vepron në mbikëqyrjen e drejtpërsëdrejti të kryetarit të Gjykatës dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të administratorit të Gjykatës;

Ndihmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi ;

Ndihmon gjyqtarët në punë që kanë të bëjnë me futjen e lëndëve në dosje;

Ndihmon në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, hetimet, gjykimet etj; Kryen edhe punë tjera sipas nevojës:

Kualifikimet:

Diploma e Fakultetit Juridik ose Master,

Njohuri të procedurave gjyqësore;

Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);

Njohuri të mjaftueshme ligjore;

Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

VËREJTJE:

• Procedura e konkursit është hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
• Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi shërbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregullore, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil dhe Udhëzimin Administrative nr.01/2015
• Konkursi është publikuar më **dt.05.12.2017 deri më dt.19.12.2017**

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Gjilan , Rr. Maria Shllaku Pn. në Gjilan në Zyrën e Pranimit dhe në Gjykatë.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

• Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11,pragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madhe të kërkesave të pranuara vetëm kandidatët e përzgjedhure në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi ku konkurron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata të tjera, dy rekomandime etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

• Fotokopjet e dokumenteve të bashkangjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.

• Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni zyrtare i/e personelit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

Na osnovu čl.4 Pravilnika o postupku zapošljavanja pripravnika **u Osnovnom sudu u Gnjilanu – i ograncima**, za volontersko stažiranje (besplatno), u roku od jedne godine

K O N K U R S

Br.4/2017

Za volonterske pripravnike:

1. **Osnovni sud Gnjilane----------35 pripravnika**
2. **Ogranak u Kamenici----------10 pripravnika**
3. **Ogranak u Vitini----------10 pripravnika**
4. **Ogranak u Novobrdo----------3 pripravnika**

Opis radnih zadataka

Naziv položaja: pripravnici
Nadzorni službenik: Administrator suda i pomočnik administratora

Posao pripravnika: Pomaže administrativnoj službi u organizovanju i održavanju predmeta, kao i upravljanje predmetima uopšte.

Glavni zadaci:
Radi pod direktnom nadzoru predsednika suda i pod opštim nadzorom sudskog administratora;
Pomaže administrativnu kancelariju u vezi organizovanja i očuvanja predmeta, kao i njihovim upravljanjem uopšte;
Pomaže sudijama na poslu oko ubacivanja spise-predmeta u dosijeima;
Pomaže u radu različite urede u sudu, uključujući registraciju, istrage, sudjenja itd;
Obavlja i druge poslove po potrebi;

Kvalifikacije:
Diploma pravnog fakulteta ili Master

Poznavanje sudskih postupaka;
Sposobnost sprovođenja sudskih (pravnih) istraga
Zadovaljajuća pravna znanja;
Odlične veštine u izradi zakonskih nacrta, uključujući mogužnost pravnih dokumenata, kao i veštine govora.

O P O M E N A:

- Postupak konkursa je otvoren za spoljne kandidate i postojeće državne službenike.
- Procedura regrutovanja se sprovodi u skladu sa procedurama predviđenim zakonom o civilnoj službi br.03/L-149 i Uredbom br.02/2010 o procedurama za zapošljavanje u državnoj službi i Administrativno uputstvo broj 01/2015.
- Konkurs je objavljen dana.05.12.2017 i isti je otvoren do.19.12.2017.

Prijave se mogu dobiti i dostaviti Osnovnom sudu u Gnjilanu, ul."Marije Shllaku", b.b., u Kancelariji za prijem i Sudu.

Kosovska civilna služba pruža jednake mogučnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.

Nevečinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima državne uprave, centralne i lokalne javne uprave, kako je navedeno u čl.11 stav 3 Zakona br.03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosova.

Prijava nakon isteka roka za apliciranje neće biti prihvačena. Zbog velikog broja primljenih prijava kontaktiraće se samo kandidati u uži izbor.

Svi građani Kosova od 18 – 64 godine imaju pravo da apliciraju. Aplikacije moraju biti jasno i čitljivo dopunjene. Svi zahtevani podaci moraju se uneti u aplikaciju. Tačno mora biti određeno mesto za koje aplicirate.

Prijava mora biti priložena potrebnim dokumentima za apliciranje, kao što je kopija diplome za završenu školu, razne profesionalne kvalifikacije, drugi sertifikati, dve preporuke itd.

Ukoliko uz aplikaciju ne priložite potrebnu dokumentaciju i istu ne popunjavate sa tačnim podacima, izgubičete priliku da uđete u užoj listi.

Fotokopija dokumenata priložena uz aplikaciju ne vraća se kandidatima.

U slučaju bilo kakvog pitanja ili dvosmislenosti možete kontaktirati službenika za perosnel-osoblje.

KËRKESË PËR OFERTË

Shërbime të Konsulencës në Prokurim

Në përputhje me Nenin 4.8 të "Rregullës së Prokurimit" të Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë

I. Numri i Prokurimit: FSDK 27/2017
I.1. FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË KOSOVË (FSDK)

II. LËNDA E KONTRATËS
II.1. Titulli i kontratës: "**Shërbime të Konsulencës në Prokurim"**

III. VENDI I REALIZIMIT
III.1. Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë-FSDK
Adresa: Rr."Pashko Vasa, Kati i I, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

IV. SPECIFIKAT TEKNIKE
IV.1. Ju lutem që t'i referoheni versionit të zgjeruar të kërkesës për ofertë të publikuar në www.fsdk.org/njoftime/prokurimet ose mund ta kërkoni përmes e-mail adresës prokurimi@fsdk.org.

V. INFORMATA ADMINISTRATIVE
V.1. Afati i fundit për dorëzimin e ofertës është deri me datë: 13.12.2017 përmes emalit prokurimi@fsdk.org.

Fondi i Sigurimit të Depositave në Kosovë
Rr. Pashko Vasa, p.n, Kati i I-rë, Lagjia "Qyteza Pejton", 10000 Prishtinë, Republika Kosovës
info@fsdk.org +381 38 610 355; + 381 38 610 356;

Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo

Komuna e Vitisë
Muncipality of Vitina
Opstina Vitina

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 dhe 5 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032 dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.13/2011, dhe Ligjit të Punës Nr.03/212, neni 8 pika 1, 2, Ligjin mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-147, neni 4, pika 4, si dhe Udhëzimin Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 mbi përzgjedhjen dhe pranimin e kuadrit arsimor, Drejtoria për Arsim shpall:

KONKURS PUBLIK

SHFMU "Halil Alidema" në Pozhoran

- Një (1) arsimtar për lëndën Kulturë Figurative, **zëvendësim** deri në kthimin e punëtorit nga pushimi mjekësor.

SHFMU "Hysen Terpeza" në Terpezë

- Një (1) mësues klasor, me kohë të pacaktuar.

SHFMU "Njzi Rexhepi" në Sllatinë të Epërme

- Dy (2) mësues klasor, **zëvendësim** deri në kthimin e punëtoreve nga pushimi i lehonisë.

SHFMU "Mirali Sejdiu" në Goshicë

- Një (1) edukatore, **zëvendësim** deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lehonisë.
- Një (1) mësues klasor, **zëvendësim** deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lehonisë.

SHFMU "Skender Emërllahu" në Ramjan

- Një (1) mësues klasor, **zëvendësim** deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lehonisë.

SHFMU "Ndre Mjeda" në Kabash, paralelja e ndarë fizike në Dobellde

- Një (1) mësues klasor, me kohë të pacaktuar.

SHMTP "Jonuz Zejnullahu" në Viti

- Një (1) profesor për lëndën Matematikë me kohë të caktuar deri më 30.04.2017, deri në kthimin e punëtorit nga pushimi pa pagesë.

SHM Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës" në Viti

- Një (1) profesor për lëndën Gjuhë Gjermane me kohë të pacaktuar,

SHFMU "Ahmet Hajdari" në Beguncë

- Një (1) punëtor teknik (pastrues).

Kandidatët të cilët konkurrojnë për pozitën e punëtorit teknik, duhet t'i plotësojnë këto kushte:
- **Të ketë diplomën e shkollës së mesme-fillore,**
- **Të ketë çertifikatën e lindjes,**
- **Të ketë çertifikatën se nuk është nën hetime,**
- **Të ketë çertifikatën e gjendjes shëndetësore.**

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende të punës, duhet të kenë përgatitje përkatëse profesionale, fakultetin (diplomën). Në mungesë të kandidatëve me përgatitje përkatëse profesionale do të merren në shqyrtim kandidatët me përgatitje përkatëse profesionale më të ulët.
Kërkesat dhe aplikacionet për konkurrim merren dhe dorëzohen në Drejtorinë për Arsim të Komunës së Vitisë.
Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Viti, më 05.12.2017

Drejtoria për Arsim

RISHPALLJE PËR TENDER PUBLIK

Furnizim dhe instalim të pajisjeve për 'Disaster Recovery Center'

Në përputhje me Nenin 4.8 të "Rregullës së Prokurimit" të Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë

I. Numri i Prokurimit: FSDK 26/2017
I.1. FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË KOSOVË (FSDK)

II. LËNDA E KONTRATËS
II.1. Titulli i kontratës: "**Furnizim dhe instalim të pajisjeve për 'Disaster Recovery Center'**

III. VENDI I REALIZIMIT
III.1. Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë-FSDK
Adresa: Rr."Pashko Vasa, Kati i I, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

IV. SPECIFIKAT TEKNIKE
IV.1. Ju lutem që t'i referoheni versionit të zgjeruar të rishpalljes për tender publik të publikuar në www.fsdk.org/njoftime/prokurimet ose mund ta kërkoni përmes e-mail adresës prokurimi@fsdk.org.

V. INFORMATA ADMINISTRATIVE
V.1. Afati i fundit për dorëzimin e ofertës është deri me datë 18.12.2017 në ora 14:00 në zyrën e FSDK-së, ndërsa hapja teknike e ofertave bëhet në të njëjtën datë 18.12.2017 në ora 14:30 në zyrën e FSDK-së.

Fondi i Sigurimit të Depositave në Kosovë
Rr. Pashko Vasa, p.n, Kati i I-rë, Lagjia "Qyteza Pejton", 10000 Prishtinë, Republika Kosovës
info@fsdk.org +381 38 610 355; + 381 38 610 356;

Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo

Komuna e Vitisë
Muncipality of Vitina
Opstina Vitina

Na osnovu clana 35 stav 1 i 5 Zakona o Preduniverzitarno Obrazovanje Republike Kosova Br.04/L-032 i Administrativnog Uputstva MONT-a br.13/2011, i Zakona rada br.03/212, clan 8 tacka 1, 2 kao i Administrativnog Uputstva MONT-a br.06/2015 o izboru i primanja obrazovnog kadra, Zakona o Civilnoj Zastiti Republike Kosova br. 03/L-147, clan 4, tacka 4, Uprava Obrazovanja objavljuje sledeci:

JAVNI KONKURS

Osnovna srednja niza skola (OSNS) "Halil Alidema" – **Pozaranje**
- Jednog/u (1) nastavnika/cu za Predmet Fizickog vaspitanja, do povratka radnika/ce sa lekarskog bolovanja.

Osnovna srednja niza skola (OSNS) "Hysen Terpeza" - Trpeza
- Jednog/u (1) razrednog nastavnika/cu sa neodredjeno vreme.

Osnovna srednja niza skola (OSNS) "Nijazi Redzepi" – Gornja Slatina
- Dva/e (2) razrednih nastavnika/ce do povratka dveju radnice sa trudnickog bolovanja.

Osnovna srednja niza skola (OSNS) "Mirali Sejdiu" – Gosice
- Jednu (1) vaspitacicu do povratka radnice sa trudnickog bolovanja.
- Jednog/u (1) razrednog nastavnika/cu zamenika do povratka radnice sa trudnickog bolovanja.

Osnovna srednja niza skola (OSNS) "Skender Emerllahu" - Ramjane
- Jednog/u (1) razrednog nastavnika/cu zamenika do povratka radnice sa trudnickog bolovanja.

Osnovna srednja niza skola (OSNS) "Ndre Mjeda" – Kabas, podeljeno fiziko odeljenje u Debolde
- Jednog/u (1) razrednog nastavnika/cu sa neodredjeno vreme.

Seredinja Profesionalna Tehbicka Skola (SPTS) "Jonuz Zejnullahu" - Vitina
- Jednog/u (1) profesora/icu za predmet Matematike na odredjeno vreme do 30.04.2017.godinu do povratka radnika sa neplacenog odmora.

Srednja Skola –Gimnazija (SSG) "Kuvendi i Lezhes" – Vitina
- Jednog/i (1) profesora/icu za Nemacki jezik na neodredjeno vreme

Osnovna srednja niza skola (OSNS) "Ahmet Hajdari" – Begunce.
- Jednog/u (1) tehnickog radnika/cu (cistaca/ica).

Kandidati koji konkurisu za poziciju tehnickog radnika/cu, trebaju ispunjavati ove uslove:
- da ima diplomu srednje ili osnovne skole,
- da ima izvod rodjenih
- da ima uverenje da nije pod istragom,
- da imaju uverenje o zdravstvenom stanju,

Kandidati koji konkurisu za ova radna mesta, trebaju imati odgovarajucu profesionalnu spremu, fakultet (diplomu). U nedostatku kandidata sa odgovarajucom profesionalnom spremom uzece se u obzir kandidati sa odgovarajucom nizom profesionalnom spremom.
Zahtevi i aplikacije za konkurisanje uzimaju se i dostave pri Upravi Obrazovanja Opstine Vitina.
Rok konkurisanja je 15 dana od dana objavljivanja konkurse preko javnog informisanja.

Vitina, 05.12.2017.godine.

Uprava Obrazovanja Opstine Vitina

Sot u bënë 40 ditë nga vdekja e bashkëshortit, e babait, e vjehrrit dhe e gjyshit tonë të dashur



LUTFI (JONOZ) OPOJA

1956 - 2017

I vlefshmi ynë, ne edhe më tutje jetojmë me kujtimet e bukura për dashurinë e tij të sinqertë, për butësinë e tij, për bujarinë e tij dhe për veprat e tij njerëzore që i le pas.
I përjetshëm është kujtimi për ty!

Të pikëlluar: Bashkëshortja Qamile, djemtë Enisi, Erdini; vajza Elida; nuset Diella, Sellda; nipat dhe mbesat.

Dje, më 04.12.2017, u bënë katër vjet të gjata pa më të dashurin tonë




NUREDIN (HABIB) HOXHA

1947 - 2013

Të përkujtojnë: Vëllai Burimi me bashkëshorten Florën, vajzën Erta, djemtë Ardi dhe Blendi nga Ferizaj.

U bënë 17 vjet nga ndarja e më të dashurit tonë



AVNI (RRUSTEM) MURIQI

1983 – 2000

Kaluan 17 vjet pa ty, nuk di nga erdh gjithë ajo forcë për ta vazhduar jetën pa Ty, nuk di si e përballuam vdekjen tënde të papritur.
Sa shumë na mungon ajo buzëqeshja jote e ëmbël dhe plot jetë, ai shikimi yt i bukur që reflektonte pozitivitet, ajo gjallëri e jotja, që vetëm ti munde të na e dhurosh neve.

E përkujtojnë me mall të pashuar: Nëna Raba, vëllezërit Enveri e Albani, motrat Florija dhe Selvija, si dhe mbarë familja Muriqi.

SHPALLJE

- Merita Regjepi-Islami shpall të pavlefshme certifikatën e trajnimit tremujor, të mbajtur më 14.11.2013. deri më 07.02.2014 në Ministrinë e Shëndetësisë.
- Murat Brahimi shpall të pavlefshme diplomën e SHMP-së "Adem Gllavica".
- Fitore K. Jerliu shpall të pavlefshme dëftesën e klasës XII dhe diplomën e gjimnazit "Zenel Hajdini", Gjilan.
- Altin Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMGJ "Gjon Buzuku", Prizren.
- Adelina Rexhaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMGJ "Gjon Buzuku", Prizren.
- Mehit Dili shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHME "Ymer Prizreni", Prizren.
- Nasredin Mazreku shpall të pavlefshme diplomën e SHM Medresesë "Allaudin", Prizren.
- Sami Hoti shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHM "12 Maji", Ratkoc.
- Antoneta Prenkaj shpall të pavlefshme dëftesën e vitit I, të SHME "Ymer Prizreni", Prizren.
- Antoneta Prenkaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës II, të SHMGJ "Gjon Buzuku", Prizren.
- Rilind Kelmendi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi", Prizren.
- SHPK "MobileMax" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 810006503.
- Ehat Ujkani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Bajram Curri", Gushac, Mitrovicë.
- Ganimete Kalludra shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Skënderbeu".
- Florije Hasani shpall të pavlefshme licencën e punës bachelor i Fizioterapisë, numër KO070-32.
- Naxhije Terziqi shpall të pavlefshme diplomën e SHMM "Dr. Ali Sokoli", Prishtinë.
- Durim Maloku shpall të pavlefshme e SHM "Eqrem Qabej", Prishtinë
- Kastriot Maloku shpall të pavlefshme e SHM "Eqrem Qabej", Prishtinë
- Valton Pllavci shpall të pavlefshme e SHME "Hoxhë Kadri Prishtina", Prishtinë
- Shkelzen Gashi shpall të pavlefshme indeksin e Fakultetit Juridik, Prishtinë
- Hamide Fetahu shpall të pavlefshme dëftesën e vitit I, II, III, IV SHM "Gjin GAzuli", Prishtinë
- Nebih Ahmeti shpall të pavlefshme dëftesën e vitit I, II të SHM " 28 Nëntori", Prishtinë
- Hazir Bajrami shpall të pavlefshme dëftesën e vitit I, II, III, IV dhe diplomën e SHM " Naim Frashëri", Shtime

CN.nr.263/2017

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Fatmir Aliu dhe sekretaren juridike Ibadete Hasani, në procedurë jokontestimore sipas propozimit të propozuesit Syla Selmani nga fsh.Llapashticë e Poshtme, Komuna e Podujevës, për provimin e vdekjes së Sylë Syla ish nga fsh.Llapashticë e Poshtme, Komuna e Podujevës, me dt.22.11.2017, publikon këtë:

SHPALLJE

Sylë Syla ish nga fsh.Llapashticë e Poshtme, Komuna e Podujevës i lindur me dt.05.03.1875 fsh.Llapashticë e Poshtme nga i ati Selman e nëna Mehreme e ka vdekur me dt.11.10.1967, në fsh.Llapashticë e Poshtme, mirëpo vdekja e tij nuk është regjistrua në zyrën në Ofiqari.

Thirret vetë Sylë Syla ish nga fsh.Llapashticë e Poshtme ose kush din diçka për personin, për kontakt, për vendndodhjen menjëherë të lajmëroi Gjykatën Themelore Prishtinë - Dega Podujevë , zyra nr .16.

Nëse në afatin prej 15 ditësh, nga dita e publikimit të kësaj shpallje në "Gazetën zyrtare" si dhe në vendet tjera publike, nuk lajmërohet vet personi Sylë Syla ish nga fsh.Llapashticë e Poshtme ose nuk lajmërohet ndonjë person që din ndonjë informatë për te gjykata do të bie aktvendim sipas propozimit për konstatimin e vdekjes.

Nga të lartcekurat u vendos si më lartë në bazë të nenit 73 dhe 74 Të Ligjit për procedurën jokontestimore.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEGA PODUJEVË

CN.nr.263/2017 prej dt.22.11.2017

Gjyqtari,
Fatmir Aliu



Aktivizo pakon me **10GB** dhe hyn në lojë për të fituar një nga **100 super-dhuratat**, me premi kryesore **10 VETURA**, përfshirë **MERCEDES GLE**.

ipko 4G

Çmimi i pakos me 10GB internet dhe 7 ditë validitet është 2.5 Eur.